

**“PËRKRAHJE PËR ZGJIDHJEN E RASTEVE TË PERSONAVE
TË ZHDUKUR – THYERJA E NGËRÇIT”**

Personat e zhdukur nga konflikti në Kosovë dhe si pasojë e tij:

Vlerësimi i gjendjes, 2017



Projekt i Financuar nga BE-ja dhe menaxhuar nga
Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë



Implementuar nga Komisioni Ndërkombëtar
për Persona të Zhdukur

Prishtinë 2017

**“PËRKRAHJE PËR ZGJIDHJEN E RASTEVE TË PERSONAVE
TË ZHDUKUR – THYERJA E NGËRÇIT”**

Ky publikim është botuar me asistencë të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Komisionit Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



Projekt i Financuar nga BE-ja dhe menaxhuar nga
Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë



Implementuar nga Komisioni Ndërkombëtar
për Persona të Zhdukur

“PËRKRAHJE PËR ZGJIDHJEN E RASTEVE TË PERSONAVE TË ZHDUKUR – THYERJA E NGËRÇIT”

PARATHËNIE

Trashëgimia e konfliktit hedh hije të gjatë mbi marrëdhëniet në mes të njerëzve, dhe vendeve dhe përkeqëson përpjekjet për ndërtimin e paqes së qëndrueshme dhe ri-pajtimit. Një nga sfidat më të mëdha është çështja e numrit të madh të personave të zhdukur, posaçërisht kur këto zhdukje janë të lidhura me konfliktin dhe shkeljet e të drejtave të njeriut. Kjo përfshinë aspektet e ndërvarura politike, ligjore, teknike dhe shoqërore të cilat duhet trajtuar me efektivitet në mënyrë që të vendoset sundimi i ligjit, zhvillohet shoqëria demokratike përmes institucioneve llogaridhënëse dhe të drejta dhe ju mundësohet familjeve të të zhdukurve realizimi i të drejtave të tyre për të vërtetën, drejtësinë dhe dëmshpërblimet.

Kanë kaluar tetëmbëdhjetë vjet që nga përfundimi i konfliktit në Kosovë. Janë bërë përpjekje masive nga autoritetet, në të dyja, në Kosovë dhe Serbi si dhe nga komuniteti ndërkombëtar, për kërkimin dhe identifikimin e të zhdukurve. Operacionet në terren kanë rezultuar me zhvarrimin e më shumë se 6,000 rasteve të mbetjeve njerëzore në territorin e Kosovës dhe rreth 900 në territorin e Serbisë. Që nga viti 2002 më shumë se 2,500 raste të personave të zhdukur janë zgjidhur duke përdorur metodat efektive mjekoligjore, përfshirë këtu edhe testimin me ADN. Përafërsisht rreth 2,000 raste janë identifikuar me metoda tradicionale të identifikimit vizual para vitit 2002.¹ Sot, vlerësohet se numri i personave të zhdukur është mbi 1,660.²

Që nga përfundimi i konfliktit në Kosovë, personat e zhdukur janë gjetur në vendet nga Batajnica (afër Aeroportit të Beogradit), Bajna Basta, dhe Petrovo Selo në Serbi, deri te pothuajse në çdo komunë të Kosovës. Si pasojë e strukturave qeverisëse të ngritura pas konfliktit, procesi i gjetjes dhe identifikimit të personave të zhdukur është zbatuar ndryshe në Kosovë dhe Serbi. Në Kosovë, detyra e gjetjes dhe zhvarrimit të personave të zhdukur, fillimisht është ndërmarrë nga Tribunali Ndërkombëtar për Krime Luftë në ish Jugosllavi (TPNKLJ), i cili ka operuar në Kosovë në vitet 1999 dhe 2000. Përgjegjësia primare teknike fillimisht ishte me Administratën e Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe pas vitit 2008 me Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX).

Në Serbi, për dallim, institucionet vendore kishin përgjegjësinë kryesore të procesit të kërkimit dhe identifikimit të personave të zhdukur nga konflikti në Kosovë. Në mënyrë të ngjashme, në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor (Kroaci dhe Bosnje dhe Hercegovinë) përpjekjet për të trajtuar çështjen e të zhdukurve nuk kanë ndaluar në punën me raste, por kanë kërkuar për të forcuar mekanizmat vendore, bazuar në ligjet e vendit dhe institucionet për sundimin e ligjit. Çfarë përcakton procesin në Kosovë për dallim nga fqinjët e saj në Ballkanin Perëndimor është se ajo ka ushtruar vetëm angazhim të kufizuar aktiv dhe pjesëmarrje operationale në proces, me vetëm pronësinë e heshtur të institucioneve vendore të Kosovës. Me fjalë të tjera, Kosova është e vetmja në rajon që ka procesin e administruar nga aktorët ndërkombëtarë, deri sot, EULEX mban kompetencat e rezervuara në lidhje me personat e zhdukur. Përveç kësaj, shkalla përparimi, në kuptimin e gjetjes dhe identifikimit të personave të zhdukur përgjatë dhjetëvjeçarit të fundit është ngadalsuar në mënyrë dramatike.

¹ Komentet për Vlerësimin Teknik të Progresit në Implementimin e Standardeve për Kosovën, të përgatitura nga Përfaqësuesi i Posaçëm i KB për Kosovën, 30 nëntor 2007.

² Në bazë të kërkesave për gjurmim, KNKK ka pasur 1.665 raste aktive të personave të zhdukur në listën e konsoliduar të Kosovës në fund të vitit 2016. Në atë kohë, baza e të dhënave e ICMP përmbante 1.876 raste aktive të personave të zhdukur bazuar në referencat gjenetike të papërputhura të ofruara nga anëtarët e familjes.

“PËRKRAHJE PËR ZGJIDHJEN E RASTEVE TË PERSONAVE TË ZHDUKUR – THYERJA E NGËRÇIT”

Megjithatë, vitet e fundit, institucionet e Kosovës kanë marrë përgjegjësi në rritje për përcaktimin e fatit dhe vendndodhjes së personave të zhdukur. Ky zhvillim duhet të konsiderohet në mënyrë të favorshme dhe mbështetet, për ti mundësuar qeverisë për të përmbushur detyrimet e saj në një mënyrë jo-diskriminuese, transparente dhe të përgjegjshme. Proceset e brendshme për të trajtuar çështjen e personave të zhdukur ndihmojnë për të siguruar se ajo është trajtuar në mënyrë më gjithëpërfshirëse duke i mundësuar shoqërisë të vlerësojë gjendjen e personave të zhdukur, të diskutoj opsionet në dispozicion, dhe për të marrë pronësinë e sukseseve dhe mangësive njësoj.

Çështja e statusit të Kosovës ka ndikuar në marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë dhe ka paraqitur një sfidë të rëndësishme për zhvillimin e bashkëpunimit midis Beogradit dhe Prishtinës në trajtimin e çështjes së personave të zhdukur. Me gjithë faktin se Serbia nuk e njeh Kosovën si shtet të pavarur, dy vendet vitet e kaluara kanë arritur marrëveshje kyçe në sektorin e drejtësisë, energjetikës, telekomunikacionit dhe në lidhje me Asociacionin e Komunave Serbe në Kosovë. Bashkëpunimi më i ngushtë në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet inkurajuar me qëllim të mundësimit të mekanizmave vendor për të shtyrë procesin përpara dhe për të siguruar përfitime afatgjata në kuptimin e paqes, drejtësisë dhe ri-pajtimit.

Angazhimi i KNPZH në proces ka filluar në vitin 1999 dhe është fokusuar në ndërtimin e kapaciteteve të brendshme për gjetjen e personave të zhdukur në mënyrë të besueshme. Puna e KNPZH në Kosovë u fokusua në sigurimin se transparenca dhe standardet e të drejtave të njeriut aplikohen plotësisht gjatë përcaktimit të fatit dhe vendndodhjes së personave të zhdukur. KNPZH ndihmoi në krijimin dhe forcimin e institucioneve vendore që kanë qenë përgjegjëse për çështjen e personave të zhdukur në Serbi dhe në Kosovë. KNPZH ka mbështetur përpjekjet për përmirësimin e dialogut në mes të Prishtinës dhe Beogradit dhe ka punuar për të promovuar kapacitetet e Komisionit Qeveritar për Personat e Zhdukur që nga krijimi i tij në vitin 2006. Paralelisht, ai ka fuqizuar angazhimin e familjeve të personave të zhdukur si një element kyç në proces, duke i ndihmuar ato të arrijnë kapacitetin për të realizuar të drejtat e tyre dhe të mbajnë autoritetet përgjegjëse. Që nga viti 2001, KNPZH gjithashtu i ofroi ndihmë teknike Qeverisë së Serbisë në gjetjen, zhvarrimin dhe identifikimin e personave të zhdukur nga konflikti në Kosovë. Në vitin 2003, KNPZH nënshkroi një marrëveshje me UNMIK-un për të ndihmuar me identifikimet e bazuara në ADN dhe që nga tetori i vitit 2008, KNPZH ka ndihmuar EULEX-in me ofrimin e testimit dhe përputhjen e ADN-së me qëllim të identifikimit të personave të zhdukur.

Një nga sfidat që duhet të trajtohet në mënyrë që të shtyhet procesi përpara është zgjidhja e çështjes së rreth 400 mbetjeve mortore të paidentifikuara në morgun e Prishtinës, të cilat mund të jenë rezultat i identifikimeve të gabuara në 1999 dhe 2000, para se testimi i ADN-së u prezantua si mjeti kryesor i identifikimit njerëzor. Mbledhja e mostrave tjera referente gjenetike nga anëtarët e familjes të cilët identifikuan të zhdukurit e tyre nëpërmjet metodave tradicionale, pra pa ndihmën e ADN-së, mund të bëjë të mundur zgjidhjen e një numri të konsiderueshëm të rasteve të mbetjeve mortore të paidentifikuara në morgun e Prishtinës dhe të sigurojë drejtimin e qartë për të synuar trajtimin e identifikimeve të gabuara. KNPZH është duke punuar me autoritetet, me organizatat partnere dhe me familjet e të zhdukurve për ta çuar këtë proces përpara.

Familjet e të zhdukurve kanë kërkuar në mënyrë të përsëritur nga autoritetet e Kosovës dhe Serbisë një proces të hapur dhe transparent për të trajtuar çështjen e ndërlidhur të identifikimeve të gabuara dhe rasteve NN. Një prej konkluzioneve nga një takim i familjeve të të zhdukurve, i cili përfshinte anëtarë të familjeve të serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës, të pritur nga LMT, Princi i Uellsit në Shtëpinë Clarence në Londër në mars 2017, ishte që shtetet duhet të ndërmarrin veprime të koordinuara për të zgjidhur rastet e mbetjeve të paidentifikuara njerëzore në mënyrë sistematike

“PËRKRAHJE PËR ZGJIDHJEN E RASTEVE TË PERSONAVE TË ZHDUKUR – THYERJA E NGËRÇIT”

dhe trajtojnë çështjen e identifikimeve të gabuara që kanë ndodhur para përdorimit të testimi të ADN-së.

Roli i KNPZH në trajtimin e çështjes së personave të zhdukur në Kosovë është pjesë e përpjekjeve të gjera që përfshijnë individ dhe organizata përgjat viteve. Jo përfshinë autoritetet vendore dhe institucionet ndërkombëtare të cilat i kanë dedikuar vite të tëra procesit të trajtimit të çështjes të falënderojë institucionet vendore dhe ndërkombëtare që i kanë kushtuar vite procesit të adresimit të çështjes së personave të zhdukur si rezultat i konfliktit në Kosovë. Në Kosovë, institucionet vendore përfshijnë: Komisionin e Kosovës për Persona të Zhdukur, Institutin e Kosovës për Mjekësi Ligjore dhe Prokurorinë Speciale të Kosovës. Në Serbi institucionet e brendshme përfshijnë: Komisionin Serb për Persona të Zhdukur, dhe Dhomën e Specializuar për Krime Lufte dhe Prokurorinë. Institucionet ndërkombëtare, të cilat falënderojmë, përfshijnë: Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish Jugosllavinë, Forcën e NATO-s në Kosovë (KFOR), Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë, Zyra e UNMIK-ut për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore, Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Këshilin e Evropës (KiE), Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PKBZH), Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë dhe Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq dhe Amnesty International.

Përveç kësaj, Qendra për të Drejtat e Njeriut dhe Qendra për të Drejtën Humanitare me seli në Beograd/Prishtinë dhe Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese janë angazhuar pa u lodhur për të raportuar për këtë çështje. Zyra e Iniciativës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë ka nxitur përpjekjet vjetore për të përkujtuar personat e zhdukur nga konflikti në Kosovë për të siguruar që ajo të mbahet në sytë e publikut.

Ky raport i dedikohet të mbijetuarve dhe familjeve të zhdukurve nga konflikti i Kosovës, të cilët qëndrojnë së bashku duke kërkuar që të gjitha rastet e personave të zhdukur të hetohen në mënyrë të duhur dhe t'u përgjigjen pothuajse 10,000 familjeve të mbijetuara të cilat ende nuk kanë informacion mbi fatin dhe rrethanat e zhdukjes së të dashurve të tyre të zhdukur. Është e rëndësishme që autoritetet në Beograd dhe Prishtinë të gjejnë rrugë më të fuqishme për bashkëpunim dhe zgjidhjen e rasteve të mbetura dhe se janë të angazhuar për sigurimin e të drejtave të familjeve të të zhdukurve për të vërtetën, drejtësinë dhe dëmshpërblimet, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike, fetare ose origjina kombëtare, ose rolin e personit të zhdukur gjatë konfliktit.

Ky është raporti i tretë i KNPZH mbi vlerësimin e përpjekjeve për gjetjen e personave të zhdukur nga konflikti në Kosovë dhe për fat të keq përparim u vogël është arritur qëkur KNPZH publikoi raportin e tij të fundit në vitin 2010. Është qëllim i KNPZH që ky raport të ndihmojë drejtimin e veprimeve të ardhme nga autoritetet në Kosovë dhe Serbi, komunitetit ndërkombëtar dhe shoqatat e familjeve të të zhdukurve në mënyrë efektive.

Kathryne Bomberger
ICMP Drejtoreshë e Përgjithshme

**“PËRKRAHJE PËR ZGJIDHJEN E RASTEVE TË PERSONAVE
TË ZHDUKUR – THYERJA E NGËRÇIT”**

Përmbajtje

**“PËRKRAHJE PËR ZGJIDHJEN E RASTEVE TË PERSONAVE
TË ZHDUKUR – THYERJA E NGËRÇIT”**

Lista e Tabelave dhe Grafikoneve

Tabela 1	Afati kohor i institucioneve përgjegjëse për zhvarrosjet në territorin e Kosovës
Tabela 2	Zhvarrimet e kryera nga ekipet e mjekësisë ligjore të TNPKLJ, si dhe grupet e mbetjeve njerëzore të zhvarrosura
Tabela 3	Zhvarrimet e kryera nga Njësia e UNMIK-ut për Personat e Zhdukur dhe grupet e mbetjeve njerëzore të rikuperuara
Tabela 4	Zhvarrimet e kryera nga ZPZHML, dhe grupet e mbetjeve njerëzore të rikuperuara
Tabela 5	Zhvarrimet nga DML/IML (EULEX/Departamenti i Drejtësisë i Kosovës)
Figura 1	Numri i gërmimeve në terren dhe numri i grupeve të mbetjeve njerëzore të rikuperuara gjatë vitit 1999-2016
Figura 2	Raportet Unike të ADN-së të paraqitura sipas vitit
Figura 3	Numri i personave të zhdukur të përfaqësuar nga grupet e mostrave të mbledhura referente familjare të ADN-së, numri i grupeve që mbeten të papërputhura
Figura 4	Numri i profileve unike post mortem të pranuar nga ICMP në periudhën 2002-2016
Figura 5	Raportet e dorëzuara të ri-bashkimeve, 2002-2016
Figura 6	Numri i grupeve të papërputhura të profileve referente familjare të ADN-së dhe numri i profileve unike PM të papërputhura

**“PËRKRAHJE PËR ZGJIDHJEN E RASTEVE TË PERSONAVE
TË ZHDUKUR – THYERJA E NGËRÇIT”**

SHKURTESAT

ADN	Acidi Dezoksiribonukleik
AKF	Agjencioni i Kosovës për Forenzikë
CIVIPOL	Policia Civile e KB
DML	Departamenti për Mjekësi Ligjore
DD	Departamenti i Drejtësisë
EULEX	Misioni i BE-së për Sundimin e Ligjit
GP	Grupi Punues për Personat e Zhdukur në Lidhje me Ngjarjet në Kosovë
GPPZH	Grupi i Politikave i Qeverisë për Personat e Zhdukur
iDMS	Sistemi i Menaxhimit të Dhënave Identifikuese i KNPZH
IML	Instituti për Mjekësi Ligjore
IPVQ	Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes
IRJM	Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë
KB	Kombet e Bashkuara
KiE	Këshilli i Evropës
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KFOR	Forca e Kosovës
KNKK	Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq
KNPZH	Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur
KIZHV	Komisioni për Zhvarrimin dhe Identifikimin e Viktimave
KQPZH	Komisioni Qeveritar për Personat e Zhdukur
NATO	Organizata e Traktatit Veri-Atlantik
NJQHP	Njësia Qendrore për Hetime Penale
NJPZH	Nësia për Personat e Zhdukur
NJHKL	Njësia për Hetimin e Krimeve të Luftës
NN	Pa emër
OSBE	Organizata për siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PM	Post Mortem
PSK	Zyra e Prokurorisë Speciale të Kosovës
PSHT	Përsëritja e Shkurtër në Tandem
PKBZH	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
RS	Republika e Serbis
RFJ	Republika Federale e Jugosllavisë
QKO	Qendra e Kërkimit Online e KNPZH
TPNKLJ	Tribunali Penal Ndërkombëtarë për Krime lufte në ish Jugosllavi
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
UNMIK	Administrata e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara në Kosovë
YIHR	Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut
ZBE/PSBE	Zyra e Bashkimit Evropian/Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian

“PËRKRAHJE PËR ZGJIDHJEN E RASTEVE TË PERSONAVE TË ZHDUKUR – THYERJA E NGËRÇIT”

FJALORI

ADN

ADN është molekulë në formë zinxhiri e cila përmban materialin e trashëguar të gjetur në pothuajse të gjitha qelizat e trupit të njeriut. Gjysma e ADN-së trashëgohet nga nëna juaj ndërsa gjysma tjetër nga babai. ADN përmban informacionin biologjik i cili përdoret nga natyra për të ndërtuar dhe mirëmbajtur trupin tonë dhe përcakton shumë karakteristika të veçanta të një individi.

MOSTRA REFERENTE FAMILJARE E ADN-së

Mostër referente gjenetike mund të jenë disa pika gjaku ose strishë bukale, të cilat janë dhënë nga familjarët e personit të zhdukur. ADN nxirret nga mostrat referente dhe mund të krahasohet me ADN-në nga mbetjet mortore në mënyrë që të gjendet përputhja e ADN-së.

PROFILI I ADN-së

Kur ADN testohet për identifikimin e personave të zhdukur, hetohen vetëm pjesë të posaçme të vogla, ose lokacione të ADN-së. Këto pjesë të vogla janë shumë të ndryshueshme dhe mund të gjenden në numër të madh kombinimesh. Karakteristikat e ADN-së në këto lokacione mund të shkruhen në një emërtim numerik i cili quhet profili i ADN-së. Çdo individ (përveç binjakëve identik) ka profil unik të ADN-së.

MOSTRA POST MORTEM

Mostra Post Mortem mund të jetë një copëz kocke apo dhëmbi e marrë nga mbetjet njerëzore

PËRPUTHJA e ADN-së

Ky term përdoret kur profili i ADN-së i nxjerrë nga mbetjet mortore përputhet me profilin e ADN-së nga mostrat referente gjenetike familjare. Kjo jep nivel të lartë sigurie se mbetjet mortore kanë lidhje me familjen.

“PËRKRAHJE PËR ZGJIDHJEN E RASTEVE TË PERSONAVE TË ZHDUKUR – THYERJA E NGËRÇIT”

I. HYRJE

Gati 18 vjet pas përfundimit të armiqësive të armatosura në Kosovë, fati i personave të zhdukur, një trashëgimi tragjike e konfliktit të armatosur gjatë viteve 1998-99 dhe si pasojë e tij, mbetet një çështje e një rëndësie kritike për shërim pas konfliktit, por në të cilën progresi është gjithnjë e më i vështirë të arrihet. Çështja prek të gjitha komunitetet dhe, nëse nuk zgjidhet në mënyrë të paanshme dhe objektive, do të kontribuojë në stërzgjatjen e një atmosfere të mosbesimit, duke rënduar brishtësinë e qeverisjes së pasluftës dhe paqen dhe sigurinë rajonale. Nga rreth 4,500 të zhdukur si rezultat i konfliktit të armatosur të viteve 1998-99 dhe pas tij, me përdorimin e teknologjisë së ADN-së të KNPZH janë identifikuar mbetjet mortore të më shumë se 2,500 prej tyre.

Sikur edhe në vendet tjera të Ballkanit Perëndimor, të prekura nga çështja e personave të zhdukur, numri i mbetjeve të zhvarrosura mortore nga varrezat e jashtëligjshme në nivel vjetorë ka rënë në mënyrë të theksuar që nga viti 2005 dhe çështja e personave të zhdukur hedh hije mbi marrëdhëniet në mes të Shqiptarëve dhe Serbëve në Kosovë, dhe marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë duke nënvlerësuar perspektivën e normalizimit dhe ri-pajtitimit.

Ky është raporti i tretë i KNPZH i vlerësimit të gjendjes në Kosovë dhe pason publikimet e raporteve në vitin 2005³ dhe 2010⁴. KNPZH vazhdon të jetë i brengosur me faktin se prej më shumë se një dekade ka pasur përparim të pakët në gjetjen e personave të zhdukur. Për më tepër, arsyeja e mungesës së përparimit në gjetjen e personave të zhdukur dhe shqyrtimi i problemit të identifikimeve të gabuara potenciale nuk është shqyrtuar në mënyrë të duhur. Gjithashtu, përpjekjet për tu siguruar se institucionet vendore në Kosovë kanë rrolin udhëheqës në proces, gjer më tani kanë qenë minimale gjë që nuk jep shpresë për qëndrueshmërinë në të ardhmen e procesit të personave të zhdukur.

Ky raport shqyrton institucionet dhe kontekstin zhvillimorë në të cilin ka ndodhur kërkimi për të zhdukurit: ballafaqon qasjet e ndryshme për trajtimin e çështjes së personave të zhdukur në Serbi dhe Kosovë; shqyrton legjisllacionin në lidhje me personat e zhdukur në Kosovë; merr parasysh rolin e rëndësishëm të familjeve të personave të zhdukur, sistemet e të dhënave të përdorura për të menaxhuar procesin e rasteve të personave të zhdukur, dhe shtjellon përdorimin, e ADN-së me qëllim të identifikimit të të zhdukurve në Kosovë dhe në fund, ofron rekomandimet për ta çuar procesin përpara.

II. KONTEKSTI HISTORIK

Gjatë periudhës së Jugosllavisë Socialiste (1946–1990) territori i Kosovës ka qenë krahinë e Jugosllavisë. Kushtetuta e Jugosllavisë e vitit 1974 i dha Kosovës autonomi thelbësore duke i mundësuar të ketë administratën e vet, kuvendin, gjyqësorin si dhe anëtarësinë në presidencën dhe parlamentin Jugosllav në të cilin kishte fuqinë e vetos. Tensionet në rritje eskaluan gjatë viteve 80 kur shqiptarët e Kosovës kërkuan statusin e Republikës brenda Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë. Në vitin 1989 administrata e Milosevicit redukoi statusin e autonomisë së veçantë të Kosovës të dhënë me Kushtetutën e vitit 1974. Shqiptarët e Kosovës u përgjigjen me një lëvizje paqësore qëllimi final i së cilës ishte arritja e pavarësisë. Kur po shpërbëhej ish

³ Shiko *Situata në Kosovë: Vlerësimi i Gjendjes*, ICMP.FSD.18.05.doc:
<http://www.icmp.int/wp-content/uploads/2007/11/icmp-fsd-18-05-1-doc.pdf>.

⁴ Shiko *Situata në Kosovë: Vlerësimi i Gjendjes*, ICMP.DG.264.4.doc:
<http://www.icmp.int/wp-content/uploads/2007/11/icmp-dg-264-4-doc-general.pdf>.

“PËRKRAHJE PËR ZGJIDHJEN E RASTEVE TË PERSONAVE TË ZHDUKUR – THYERJA E NGËRÇIT”

Jugosllavia, në gjysmën e parë të viteve 1990, u rritën tensionet në territorin e Kosovës. Minoriteti Serb në Kosovë kërkonte të mbetej brenda Republikës Federale të Jugosllavisë (Serbia dhe Mali i Zi), përderisa shqiptarët e Kosovës kërkonin vetëvendosje dhe Kosovën e pavarur. Metoda jo të dhunshme të kërkimit të pavarësisë u mbizotëruan nga metodat ushtarake në mes të viteve 1990. Përplasjet në mes të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe forcave të RFJ eskaluan në pjesën e dytë të viteve 1990, duke kulmuar me konfliktin e armatosur nga 5 marsi i vitit 1998 e deri me 11 qershor 1999. Pas dështimit të gjetjes së një zgjidhje diplomatike në Rambouillet në pranverën e vitit 1999, dhe në dritën e eskalimit të krizës humanitare, NATO filloi fushatën e sulmeve ajrore kundër forcave dhe stabilimenteve ushtarake në Kosovë dhe Serbi. Konflikti i armatosur në mes të forcave të RFJ dhe UÇK u karakterizua me spastrim etnik, shkatërrim të pronës dhe rezultoi me më shumë se 13,500 të vrarë dhe të zhdukur.⁵

Me 9 qershor 1999 në Kumanovë, Maqedoni (IRJM) NATO Forca e Kosovës (KFOR) dhe Qeveria e Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Republikës së Serbisë arritën Marrëveshjen Tekniko-Ushtarake (e njohur si marrëveshja e Kumanovës). Pikat kyçe të Marrëveshjes Tekniko-Ushtarake ishin: ndalimi i armiqësive në mes të KFOR dhe Republikës Federale të Jugosllavisë, tërheqja e forcave të RFJ nga Kosova, dhe zbarrimi i forcave civile të KB dhe forcave të sigurisë së NATO-s (KFOR) brenda Kosovës. Me 10 qershor 1999, Këshilli i Sigurimit i OKB miratoi Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB 1244, e cila e vendoste Kosovën nën administrimin e përkohshëm të KB (UNMIK) dhe autorizonte KFOR si forcë paqeruajtëse në territorin e Kosovës.⁶ Në dhjetor të vitit 2008, Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) është vendosur në gjithë territorin e Kosovës, duke marrë përgjegjësitë në fushën e policisë, doganave dhe gjyqësorit, e cila kishte qenë më parë përgjegjësi e UNMIK-ut. Në vitin 2008, autoritetet e Kosovës shpallën pavarësinë. Në vitin 2010, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në mendimin e saj këshillëdhënëse erdhi në përfundim se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk ka shkelur as të drejtën e përgjithshme ndërkombëtare apo Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së si pjesë e ligjit të aplikueshëm ndërkombëtar. Serbia dhe një numër i vendeve të tjera nuk e njohin Kosovën si një shtet sovran. Kjo ka implikime në lidhje me atë se si institucionet në Kosovë dhe Serbi që janë përgjegjëse për çështjen e personave të zhdukur bashkëpunojnë me njëri-tjetrin.

Ngjarjet e vitit 1998 dhe 1999 në territorin e Kosovës, të cilat *ndër të tjera* kanë rezultuar në zhdukjen me forcë dhe ekzekutimin e një numri të madh të personave, dhe rrethanat pas konfliktit, kanë paraqitur sfida të rëndësishme në procesin e kërkimit të zhdukurve. Territori i Kosovës përbën një zonë të përbashkët konflikti e cila prek shqiptarët dhe serbët e Kosovës. Personat u zhdukën me forcë në territorin e Kosovës në 1998-1999 dhe u ekzekutuan, dhe trupat e tyre ishin varrosur në varret e jashtëligjshme në Kosovë. Para tërheqjes së forcave të RFJ-së në qershor të vitit 1999, në prag të marrëveshjes së Kumanovës, besohet se varrezat primare janë grabitur dhe trupat e ri-zhvarrosura janë transportuar në Serbi dhe u varrosën në varrezat e jashtëligjshme dytësore. Nga qershori i vitit 1999 deri në fund të vitit 2000 një numër i jo-shqiptarëve u zhduk me forcë dhe u ekzekutuan dhe mbetjet e tyre njerëzore janë ri-varrosur në vende të panjohura. Familjet e të zhdukurve dhe autoritetet-Serbët në Beograd dhe në të gjithë Serbinë dhe Kosovën, dhe shqiptarëve në Prishtinë dhe në tërë Kosovën-kanë një interes në gjetjen e varrezave të jashtëligjshme në territorin që është ose nën juridiksionin apo kontrollin e tjetrit

⁵ <http://www.hlc-rcd.org/?p=28185&lang=de>.

⁶ Rezoluta 1244 parashikonte që Kosova do të kishte autonomi brenda Republikës Federale të Jugosllavisë, dhe afirmonte integritetin territorial të Republikës Federale të Jugosllavisë, i cili që atëherë është trashëguar nga Republika e Serbisë.

“PËRKRAHJE PËR ZGJIDHJEN E RASTEVE TË PERSONAVE TË ZHDUKUR – THYERJA E NGËRÇIT”

Në këto rrethana, llogaridhënia në nivelet më të larta të qeverisë, vullneti politik dhe bashkëpunimi mes autoriteteve të Prishtinës dhe Beogradit është një parakusht për të adresuar çështjen e personave të zhdukur nga konflikti në Kosovë në mënyrë efektive. Bashkëpunimi, megjithatë, është dëshmuar të jetë i shkurtër dhe bishtëruës në kohë, për disa arsye. Bashkëpunimi i drejtpërdrejtë ndërmjet autoriteteve të Prishtinës dhe Beogradit ka qenë i penguar nga çështjet politike që nuk kanë të bëjnë me çështjen e të zhdukurve, apo, anasjelltas, si pasojë e pompoziteti nga autoritetet në të gjitha anët që kanë kërkuar ta përdorin çështjen për qëllime politike. I rëndësishëm gjithashtu ka qenë fakti se procesi ka qenë i dominuar nga komuniteti ndërkombëtar, i cili e ka ndjekur çështjen si një shqetësim humanitar, teknik, dhe ka anashkaluar nevojën për të ndërtuar strukturat llogaridhënese politike, qeverisëse dhe për sundimin e ligjit në Kosovë. Rasti i fuqisë së rezervuar të bashkësisë ndërkombëtare është i shtrirë në kohë. Kjo fuqi e rezervuar është më e theksuar në fushën e sundimit të së drejtës, sektorit i cili përfshin çështjen e personave të zhdukur. Në këtë drejtim, bashkësia ndërkombëtare ka menaxhuar institucionet policore, juridike dhe doganore të Kosovës. Ajo ka përzgjedhur gjyqtarët ndërkombëtarë dhe prokurorët dhe rastet që ata do të gjykojnë. Ajo ka të drejtë të anulojë vendimet e qeverisë së Kosovës dhe për të "marrë përsipër përgjegjësi të tjera, në mënyrë të pavarur ose në mbështetje të autoriteteve kompetente të Kosovës", për të ruajtur ligjin, rendin publik dhe sigurinë.

III. INSTITUCIONET DHE KONTEKSTI I SHITJELLUAR

Në Kosovë, detyra për gjetjen, zhvarrimin dhe identifikimin e personave të zhdukur është ndërmarrë kryesisht nga organizatat ndërkombëtare. Në territorin e Serbisë, institucionet vendore, të udhëhequra nga gjykatat dhe të koordinuara së pari nga Qendra Koordinuese e Kosovës e më vonë Komisioni i Qeverisë së Serbisë për Personat e Zhdukur kanë qenë përgjegjëse për kërkimin, zhvarrimin dhe identifikimin e personave të zhdukur.

Tribunali Penal Ndërkombëtarë për ish Jugosllavi (TPNKLJ) ishte përgjegjës për punën e hershme të zhvarrimeve në territorin e Kosovës. Zhvarrimet, kryesisht ndërmerreshin në lidhje me hetimet penale, por gjithashtu, me raste, kishin për qëllim edhe identifikimin e mbetjeve mortore. Qëllimi i këtyre zhvarrimeve ishte për të mbledhur dëshmi për përndjekjen e anëtarëve të lidhshmit Serb i cili ishte akuzuar në maj të vitit 1999 nga TPNKLJ për krimet e luftës në Kosovë.⁷ Nga qershori i vitit 1999, zhvarrimet ndërmerreshin nga ekipet ad hoc mjeko-ligjore të ekspertëve ndërkombëtar të cilët punon për TPNKLJ, i themeluar me rezolutë të Këshillit të Sigurimit të KB në maj të vitit 1993, i cili kishte juridiksion për krimet e luftës në Kosovë.⁸ Hetuesit e TPNKLJ u vendosën nën mbrojtjen e KFOR-it. Mbledhja e dëshmive të krimeve të luftës filloi me arritjen e NATO në vitin 1999 me ekipet e pavarura nga disa vende të cilat operonin nën koordinimin e TPNKLJ.⁹ Në fjalimin e saj para Këshillit të Sigurimit të KB me 21 nëntor të vitit 2000, Kryeprokurorja e TPNKLJ Carla Del Ponte nënvizoi se në vitin 1999 ekipet mjeko-ligjore të TPNKLJ zhvarrosën 2,108 trupa nga 195 lokacione në territorin e Kosovës.¹⁰ Në vitin 2000, ekipet mjeko-ligjore të TPNKLJ vlerësuan edhe 325 vend varrime tjera dhe zhvarrosën

⁷ Prokurori kundër Slobodan Milošević, Milan Milutinović, Nikola Sainović, Dragoljub Ojdanović, Vljako Stojiljković,, (IT-99-37-I), 23 maj 1999. Pesë të pandehurit u akuzuan për përgjegjësinë komanduese për krime kundër njerëzimit dhe shkeljeve të dokeve dhe zakoneve të luftës të kryera në Kosovë.

⁸ S/RES/827(1993), 25 Maj 1993; CC/PIO/302-E, Deklarata e Prokurorit në lidhje me juridiksionin mbi Kosovën, 10 mars 1998://www.icty.org/sid/7683, accessed April 2009.

⁹ Raport i aktiviteteve të ZPHML UNMIK OMPF 2002-2004, f.8.

¹⁰ Fjalimi para Këshillit të Sigurimit nga Carla Del Ponte, Kryeprokurorja e Tribunalit Penal për ish Jugosllavi dhe Ruandë, në Këshillin e Sigurimit të KB, 24 nëntor 2000, <http://www.icty.org/en/press/address-security-council-carla-del-ponte-prosecutor-international-criminal-tribunals-former>.

“PËRKRAHJE PËR ZGJIDHJEN E RASTEVE TË PERSONAVE TË ZHDUKUR – THYERJA E NGËRÇIT”

1,577 trupa si dhe gjetën mbetje të pakompletuara në 258 raste tjera.¹¹ Kryeprokurorja e TPNKLJ arriti në përfundim se “paraprakisht në përgjithësi gjatë dy viteve janë zhvarrosur 4,000 trupa të cilat edhe janë ekzaminuar.”¹²

Në këtë periudhë, mungesa e procedurave standarde operative dhe centralizimi i papërshtatshëm kanë çuar në problemet me dëshmitë e mbledhura.¹³ Në një përpjekje për të demonstruar se krimet ishin sistematike dhe të përhapura, ekipet e TPNKLJ kanë kryer autopsitë në sa më shumë trupa që ishte e mundur, duke kryer pak apo aspak punë identifikuese; për më tepër, trupa të paidentifikuar të zhvarrosur në vitin 1999 u rivarrosën në vende që nuk janë shkëmbyer me UNMIK-un apo institucionet e ngarkuara me vazhdimin e procesit hetimor.¹⁴ Këto çështje rezultuan me pengesa të rëndësishme gjatë përpjekjeve vijuese për të trajtuar çështjen e personave të zhdukur.

Deri në vitin 2001 trupat e zhvarrosur u identifikuan me metoda tradicionale, zakonisht kur anëtarë i familjes njihin rrobat ose gjërat personale të gjetura me trupin. Fotografitë e këtyre gjëseneve publikoheshin nga KNKK dhe OSBE në serinë e “Librave të Gjëseneve”.¹⁵

Në nëntor të vitit 1999, u themelua Njësi për Persona të Zhdukur në kuadër të Policisë së UNMIK-ut i mandatuar për hetimin e ose vend ndodhjes së mundshme të personave të zhdukur ose/dhe vend-varrezave. NJPZH së bashku me Njësinë Qendrore Hetuese Penale (NJQHP) të policisë së UNMIK-ut, dhe më vonë të njësisë së dedikuar për Hetimin e Krimeve të Luftës (NJHKL) ishin përgjegjës për aspektet penale të rasteve të personave të zhdukur në Kosovë. NJPZH ishte përgjegjës për kërkesat gjyqësore të cilat autorizojnë zhvarrimet dhe ndërmarrjen e zhvarrimeve, së bashku me arkeologët dhe/ose antropologët mjeko-ligjorë.¹⁶ Deri në prill të vitit 2002 NJPZH ndërmori 69 zhvarrime dhe gjeti 85 trupa.¹⁷ Në maj të vitit 2000, u krijua Komisioni për Zhvarrimin dhe Identifikimin e Viktimave (KZHIV) i kryesuar nga UNMIK-u për zhvarrimin, identifikimin dhe ruajtjen e mbetjeve mortore.¹⁸

Në maj të vitit 2002 UNMIK-u ka themeluar Zyrën për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore (ZPZHML) në Departamentin e Drejtësisë të UNMIK-ut (DD), i cili u bë operacional në qershor të vitit 2002, duke e bërë autoritetin e vetëm në territorin e Kosovës, me një mandat për të përcaktuar vendndodhjen e personave të zhdukur, për të identifikuar mbetjet e tyre mortore dhe kthimin e tyre në familjen e të zhdukurit. ZPZHML ka realizuar një varg aktivitete të specializuara - zhvarrimeve forenzike, ekzaminimin post-mortem dhe krahasimin e ante-mortem me të dhënat post-mortem - deri në fund të vitit 2008. Më parë pjesë e Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut, në vitin 2007 ZPZHML ishte transferuar në Ministrinë e Drejtësisë të Kosovës, por në vitin 2008 është marrë përsipër nga misioni i EULEX-it.

Pas disa viteve të negociatave, KNPZH dhe UNMIK-u nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi më 26 nëntor 2003, që përcaktonte asistencën teknike të ICMP-së UNMIK-ut në lidhje me punën e Zyrës për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore (ZPZHML). Procesi i gjatë i negociimit, me insistimin e KNPZH ishte i përqendruar për përdorimin e ADN si një identifikues primar. Staf i

¹¹ *Ibid.*

¹² *Ibid.*

¹³ UNMIK OMPF Activity Report 2002-2004, p.8.

¹⁴ *Ibid.*

¹⁵ Amnesty International, *Burying the Past: Impunity for enforced disappearances and abductions in Kosovo*, June 2009, f.22.

¹⁶ *Ibid.*, f.19.

¹⁷ *Ibid.*, f.71.

¹⁸ Rregullorja e UNMIK-ut 2000/28 për Komisionin e Zhvarrimeve dhe Identifikimit të Viktimave.

“PËRKRAHJE PËR ZGJIDHJEN E RASTEVE TË PERSONAVE TË ZHDUKUR – THYERJA E NGËRÇIT”

mjekësisë ligjore i UNMIK-ut ishte mësuar me përdorimin e metodave tradicionale të identifikimit dhe ishin skeptik në lidhje me përdorimin e kësaj teknologjie të re që KNPZH kishte futur tashmë në rajon në vitin 2000. Kur u arrit një marrëveshje, në fund për përdorimin e ADN-së, UNMIK-u kishte refuzuar ofertën shtesë të KNPZH që të ofrojë ndihmë në gërmimet dhe në ekzaminimin e mbetjeve mortore në morgjet në Kosovë.

Ofrimi i testimit dhe përputhjes së ADN-së nga KNPZH ka qenë e një rëndësie kritike për procesin e identifikimit të besueshëm të personave të zhdukur. Gabimet e bëra para aplikimit të procesit të udhëhequr me ADN, megjithatë kishin një trashëgimi të shtrirë në kohë dhe kanë ndikuar në aftësinë e procesit për të ecur përpara.¹⁹ Kur një trup identifikohet gabimisht, familja e cila gabimisht ka pranuar trupin në shumicën e rasteve nuk ka dhënë mostrat referente të ADN-së. Prandaj, mbetjet e vërteta të anëtarit të tyre të familjes, nëse do gjenden, do të mbesin të paidentifikuara. Kështu familja, mbetjet e të afërmit të së cilës janë identifikuar gabimisht dhe kthyer po gabimisht tek një familje tjetër, nuk do të zgjidh rastin e tyre edhe nëse kanë dhënë mostrat referente të ADN-së, sepse i afërmi i tyre është varrosur nën emrin e dikujt tjetër.

Para përfundimit të marrëveshjes me UNMIK-un, KNPZH për disa vite ka qenë i angazhuar në zhvillimin e kapaciteteve të autoriteteve të Kosovës për të kërkuar të zhdukurit në përputhje me të drejtat e njeriut dhe standardet e drejtësisë në një rën anë dhe shoqatat e familjeve të personave të zhdukur për të ndihmuar ata të kërkojnë të drejtat e tyre, të punojnë së bashku me të gjitha komunitetet për të arritur qëllimet e përbashkëta, dhe të mbajnë autoritetet përgjegjëse.

Në vitin 2004, u krijua Grupi Punues për personat e zhdukur në lidhje me ngjarjet në Kosovë (GP) në mes të janarit 1998 dhe dhjetorit të vitit 2000, si rezultat i dialogut të udhëhequr nga OKB në Vjenë. KNKK-ja u ftua të kryesojë GP. Një mekanizëm rreptësishtë humanitare, GP mban seanca të rregullta në të cilat delegacionet e Prishtinës dhe Beogradit shkëmbejnë informacione dhe planifikojnë aktivitetet. Deri në fund të vitit 2016 GP ishte takuar në 43 raste. GP ka pasur sukses në sjelljen e palëve të ndryshme së bashku për të diskutuar çështjen urgjente të personave të zhdukur. Sot, megjithatë autoritetet Serbe dhe të Kosovës pohojnë se nuk kanë asnjë informacion të ri në lidhje me varreza të mundshme të jashtëligjshme.

Në vitin 2006, pas përpjekjeve të ngjashme për ndërtimin e kapaciteteve në rajonin e ish Jugosllavisë për të siguruar përgjegjësinë shtetërore për gjetjen e personave të zhdukur, KNPZH ka ndihmuar autoritetet e Kosovës për të krijuar Komisionin e Kosovës për Personat e Zhdukur, për të udhëhequr aktivitetet në lidhje me personat e zhdukur në territorin e Kosovës. Mandati i KNPZH-së përfshin mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të personave të zhdukur dhe familjeve të tyre; koordinimin e aktiviteteve në mbledhjen e të dhënave lidhur me personat e zhdukur; krijimin e një Regjistri Qendror të Personave të Zhdukur; informimin e familjarëve të personave të zhdukur dhe bashkëpunimin me shoqatat e tyre, njoftimin e anëtarëve të familjes për fatin e personave të zhdukur; rritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me dhe mbështetja e iniciativave që lidhen me personat e zhdukur si dhe raportimi publik për rezultatet e gjetjeve të tij; ndërmarrjen e aktiviteteve të tjera të rëndësishme në lidhje me personat e zhdukur; bashkëpunon me institucionet vendore dhe ndërkombëtare në kryerjen e detyrave të tij; hapjen dhe regjistrimin e rasteve të personave të zhdukur; dhe paguan shpenzimet e varrimit të personave të zhdukur të identifikuar.

¹⁹ Çështja e identifikimeve të gabuara bazuar në metodat tradicionale të identifikimit është e përbashkët për të gjitha shtetet e prekura në Ballkanin Perëndimor. Për më shumë informacion shiko raportin e KNPZH: Bosnja dhe Hercegovina, Personat e Zhdukur nga Konfliktet e Armatosura të viteve 90: Vlerësimi i Gjendjes.

“PËRKRAHJE PËR ZGJIDHJEN E RASTEVE TË PERSONAVE TË ZHDUKUR – THYERJA E NGËRÇIT”

Edhe pse, mandati i Komisionit të Kosovës për Personat e zhdukur është i ngjashëm me homologët e tij në rajon, nuk i është dhënë autoritetit politik për të bërë punën e tij – të koordinojë një proces vendor të bazuar në ligj për hetimin e rasteve të personave të zhdukur nga konflikti.

Në shkurt të vitit 2008, Kuvendi i Kosovës shpalli në mënyrë të njëanshme pavarësinë e Kosovës. Në të njëjtin muaj, mbikëqyrja ndërkombëtare e Kosovës ka kaluar nga UNMIK-u tek Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX)²⁰. Edhe pse UNMIK-u vazhdon të ekzistojë, shumë prej aktiviteteve të tij origjinale janë marrë përsipër nga organizata të tjera. Duke punuar në kuadër të Rezolutës së njëjtë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX) mori përgjegjësinë për shumë çështje të sundimit të ligjit, duke përfshirë edhe çështjen e personave të zhdukur, nga UNMIK-u në vitin 2008. Sipas planit të Veprimit të Përbashkët të Këshillit Evropian të 4 shkurtit 2008, i cili më pas u vazhdua, EULEX-i ndër të tjera do të, "monitorojë, udhëzojë dhe këshillojë institucionet kompetente kosovare në të gjitha fushat që ndërlidhen me sundimin e ligjit... duke mbajtur disa përgjegjësitë ekzekutive" dhe "të siguroj mbajtjen dhe promovimin e sundimit të ligjit... nëpërmjet kthimit ose anulimit të vendimeve operationale të marra nga autoritetet kompetente të Kosovës". Në lidhje me personat e zhdukur, EULEX-i ka ruajtur bashkëpunimin me KNPZH në bazë të memorandumit të mirëkuptimit të nëntorit të 2003 me UNMIK-un dhe mori përsipër aktivitetet e ZPZHML-së së UNMIK-ut, derisa institucionet e Kosovës do të ishin në gjendje për të marrë përgjegjësi për punën e tij. ZPZHML e EULEX-it ka një mandat të dyfishtë: "zbardhjen e fatit të personave të zhdukur", dhe "ofrimin e një sistemi mjeko-ligjor në Kosovë të standardeve evropiane". Vitet e fundit, EULEX-i ka bërë përpjekje për të rritur kapacitetet vendore mjeko-ligjore. Këto përpjekje përfshijnë trajnimin e të punësuarve, arritjen e marrëveshjeve me institucionet a arsimit të lartë dhe iniciimin e Memorandumit të Mirëkuptimit në mes të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Kulturës për ti mundësuar të pinësuarve në IML çasje në mbetjet në Muzeun e Kosovës.

ZPZHML e EULEX-it u transformua në Departamentin e Mjekësisë Ligjore (DML) në qershor të vitit 2009, që vepron nën ombrellën e Ministrisë së Drejtësisë të Kosovës dhe ofron shërbimet e mjekësisë ligjore dhe ekspertizën e hetimit të vdekjes. Në vitin 2016 DML u shndërrua në institutin e Mjekësisë Ligjore (IML). EULEX mban mandatin e rezervuar për personat e zhdukur dhe të punësuarit e EULEX-it, të cilët janë bashkë-vendosur brenda ambienteve të IML, ndihmojnë IML në antropologjinë dhe arkeologjinë mjeko-ligjore, si dhe patologjinë mjekoligjore dhe hetimin e vendit të krimit. IML mban kontakte me familjet e të zhdukurve dhe është përgjegjës për gjetjen, zhvarrimin, identifikimin dhe përcaktimin e fatit të mbetjeve mortore si dhe dorëzimin e tyre tek familjet e personave të zhdukur. Puna e IML është përcaktuar me *Ligjin për Mjekësinë Ligjore* i cili u miratua nga Kuvendi i Kosovës në Mars të vitit 2016.

Në vitin 2008, është krijuar Prokuroria Speciale e Kosovës (PSK)²¹ për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës në shkelje të rëndë të Konventave të Gjenevës, për krime lufte në shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktet e armatosura ndërkombëtare, krimet e luftës në shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët të Konventave të Gjenevës, si dhe krimet e luftës në shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që

²⁰ Me 4 shkurt 2008, Këshilli i Bashkimit Evropian miratoi Veprimin e Përbashkët 2008/124/CFSP për Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit, EULEX KOSOVO (2).

²¹ Prokuroria Speciale e Kosovës (SPK) është themeluar para dhe dallon nga dallon nga Zyra e Prokurorit Special (ZPS) e Dhomave të Veçanta të Kosovës (DHVK). Kjo e fundit u krijua në gusht të vitit 2015, kur Kosova miratoi legjislacionin që krijoi Zyrën e Prokurorit Special (ZPS) për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet e rënda ndërkufitare dhe ndërkombëtare që ndodhën gjatë dhe pas konfliktit në Kosovë në 1998, 1999 dhe 2000.

“PËRKRAHJE PËR ZGJIDHJEN E RASTEVE TË PERSONAVE TË ZHDUKUR – THYERJA E NGËRÇIT”

zbatohen në konfliktet e armatosura jo të një karakteri ndërkombëtar²². Si e tillë, ajo është përgjegjëse për hetimin e rasteve të zhdukjeve me forcë.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë Misionin e BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë thekson se PSK, institucion vendor, ka kompetencë për të gjitha rastet, duke përfshirë edhe rastet e zhdukjeve me forcë, të iniciuara *pas* 15 prill 2014. Në drejtim të përmbushjes së kompetencave të reja, PSK dhe jo EULEX, i ka nënshkruar të gjitha urdhëresat e gjykatës për hetim dhe gërmimet që nga qershori 2014, dhe vend-gërmimet kanë qenë nën juridiksionin, kontrollin dhe menaxhimin e një prokurori të PSK që atëherë. Megjithatë, rastet për të cilat vendimi për fillimin e hetimeve ishin ngritur para 15 prill 2014 mbeten brenda sferës së EULEX-it.²³

Ndërsa komuniteti ndërkombëtar ka bërë hapa në vitet e fundit për të mundësuar autoritetet e Kosovës të marrin pronësi më të madhe të procesit, ka sfida sistemike që vazhdojnë. Për shkak se mban mandatin e rezervuar për çështjen e personave të zhdukur, ajo vazhdon të mbetet nën juridiksionin e EULEX-it. Nuk është e habitshme, prandaj, që Komisioni i Kosovës mbetet një institucion i dobët, gjë e cila gjithashtu ndikon në kapacitetin e tij për të punuar në mënyrë efektive me homologun e tij serb. Për më tepër, pa marrjen e përgjegjësisë për çështjen e personave të pagjetur të autoriteteve vendore të Kosovës, aftësia e tij për të marrë pjesë në instrumente të rëndësishme ligjore ndërkombëtare është e kufizuar, duke përfshirë pjesëmarrjen në Konventën për Mbrojtjen e Personave nga Zhdukjet me Forcë dhe jo të vullnetshme, Deklaratës për përgjegjësinë e Shteteve në Adresimin e çështjes së personave të zhdukur nga konflikti i armatosur dhe shkeljet e të drejtave të njeriut.

IV. ZHVARRIMET NË TERRITORIN E KOSOVËS 1999-2016

Institucionet e shumta ndërkombëtare kanë qenë përgjegjës për gërmimet e varrezave klandestine dhe zhvarrimin e mbetjeve njerëzore në Kosovë. Në mes të qershorit 1999 dhe dhjetorit 2016, janë kryer 1,513 operacione në terren (gërmimet). Këto operacione në terren kanë rezultuar në nxjerrjen e 6,097 grupeve të mbetjeve mortore (të plotë dhe jo të plota). Është e rëndësishme të theksohet se 65 për qind e të gjitha mbetjeve njerëzore që u gjetën në 1999-2000 nga ekipet mjekoligjore të TPNKLJ, u identifikuan duke përdorur metodat tradicionale të identifikimit vizual.

²² Neni 5 i Ligjit No 03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Kosovës.

²³ Ligji Nr. 04/L-273 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve në lidhje me Mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit, Nenet 1.A (Rastet aktuale) dhe Nenet 7.B (Transferimi i rasteve).

**“PËRKRAHJE PËR ZGJIDHJEN E RASTEVE TË PERSONAVE
TË ZHDUKUR – THYERJA E NGËRÇIT”**




Figura 1:

Numri i zvarrimeve në terren dhe numri i grupeve të mbetjeve njerëzore të zvarrosura sipas viteve 1999-2016

Korniza kohore e institucioneve përgjegjëse për zvarrimet në territorin e Kosovës	Ekipeve mjeko-ligjore të TPNKLJ	Komisioni për Verifikimin, Zvarrimin dhe Identifikimin e Viktimave i UNMIK-ut (KVZHIV)	Zyra për Mjekësi Ligjore dhe Persona të Zhdukur e UNMIK-ut (ZMLPZH)	Zyra për Mjekësi Ligjore dhe Persona të Zhdukur e EULEX-it	Departamenti i për Mjekësi Ligjore dhe Persona të Zhdukur (EULEX/ Departamenti i Drejtësisë i Kosovës)	Instituti për Mjekësi Ligjore (EULEX/ Departamenti i Drejtësisë i Kosovës)
	UNMIK CIVPOL Njësi për Persona të Zhdukur					
Kohëzgjatja	1999-2000	2000-2002	2002-2008	2008-2009	2009-2016	2016-tani

Tabela 1:

Kronologjia e institucioneve përgjegjëse për zvarrimet në territorin e Kosovës

	1999	2000	TOTAL
Operacionet në terren (të gjitha zvarrimet dhe vlerësimet)	195	325	520
Numri i mbetjeve njerëzore të zvarrosura (trupat e kompletuar dhe të pakompletuar)	2,108	1,835	3,943

Tabela 2:

Zvarrimet e ndërmarra nga ekipet mjeko-ligjore të TPNJ dhe grupet e mbetjeve njerëzore të zvarrosura²⁴

²⁴ Fjalimi para Këshillit të Sigurimit nga Carla Del Ponte, Kryeprokurore e Tribunalit Penal për ish Jugosllavi dhe Ruandë, në Këshillin e Sigurimit të KB, 24 nëntor 2000, <http://www.icty.org/en/press/address-security-council-carla-del-ponte-prosecutor-international-criminal-tribunals-former>.

**“PËRKRAHJE PËR ZGJIDHJEN E RASTEVE TË PERSONAVE
TË ZHDUKUR – THYERJA E NGËRÇIT”**

	Nënt. 1999 – prill 2002	Gjithsej
Operacionet në terren (të gjitha zhvarrimet dhe vlerësimet)	69	69
Numri i mbetjeve të zvarrosura njerëzore (trupat e kompletuar dhe të pakompletuar)	85	85

Tabela 3:

Zhvarrimet e ndërmarra nga Njësi të Personat e Zhdukur CIVIPOL e UNMIK-ut dhe grupet e mbetjeve njerëzore të zvarrosura²⁵

	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	TOTAL
Operacionet në terren (të gjitha zhvarrimet dhe vlerësimet)	174	130	81	61	59	66	68	639
Numri i mbetjeve të zvarrosura njerëzore (trupat e kompletuar dhe të pakompletuar)	443	652	176	118	59	73	48	1569

Tabela 4:

Zhvarrimet e ndërmarra nga ZPZHML, dhe grupet e mbetjeve njerëzore të zvarrosura²⁶

	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Gjithsejt
Operacionet në terren (Të gjitha zhvarrimet dhe vlerësimet)	67	32	46	28	48	24	20	20	285
Numri i mbetjeve njerëzore të zvarrosura (të kompletuara)	52	26	37	10	22	75	9	1	232
Numri i mbetjeve njerëzore të zvarrosura (trupa të pakompletuar)	14	11	5	106	19	92	5	16	268

Tabela 5:

Zhvarrimet e ndërmarra nga DML/IML (EULEX/Ministria e Drejtësisë e Kosovës)²⁷

V. PËRPEKJET PËR GJETJEN E PERSONAVE TË ZHDUKUR NGA KONFLIKTI NË KOSOVË NË TERRITORIN E SERBISË

Transformimi i politikave të Serbisë karshi çështjes së personave të zhdukur nga konfliktet në rajon të viteve 1990, përfshirë edhe konfliktin në Kosovë, ndodhi pas ndryshimeve demokratike në Serbi në vitin 2000. Pas arrestimit dhe rkradimit të Slobodan Millosevic në Hagë dhe zgjedhjes së Zoran Djindjic, administrata e re kërkonte të trajtonte krimet e kryera nga regjimi dikurshëm dhe më në fund u ndërmor edhe përpjekja për të gjetur personat e zhdukur. Kjo rezultoi përgjatë viteve, me gjetjen e më shumë se 1,300 personave të zhdukur, nga të cilët

²⁵ Amnesty International, Burying the Past: Impunity for enforced disappearances and abductions in Kosovo, June 2009, p.71.

²⁶ OMPF Activity Report 2008.

²⁷ Korrespondenca me e mail, me IML/EEULEX e cila përmbante informatat relevante e pranuar me 30 mars 2017.

“PËRKRAHJE PËR ZGJIDHJEN E RASTEVE TË PERSONAVE TË ZHDUKUR – THYERJA E NGËRÇIT”

pothuajse 900 kishin të bënin me konfliktin në Kosovë.²⁸ Autoritetet Serbe punuan përmes të zyrave të Qendrës Koordinuese për Kosovën për të trajtuar çështjen e rasteve të personave të zhdukur gjer në vitin 2000, kur Komisioni për Personat e Zhdukur i Këshillit të Ministrave të Serbisë dhe Malit të Zi mori përgjegjësitë.

Në vitin 2001, KNPZH nënshkroi marrëveshje me Serbinë e cila përfshinte ndihmën në zhvarrimin e mbetjeve mortore të personave të zhdukur nga konflikti në Kosovë dhe duke përdorur sistemin e udhëhequr nga ADN të KNPZH për identifikimin e mbetjeve mortore të shqiptarëve të Kosovës.

Marrëveshjet e nënshkruara në vitin 2001 me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Qendrën Koordinuese të Kosovës, krijuan bazën ligjore për KNPZH për të filluar ofrimin e ndihmës për Gjykatën e Qarkut në Beograd në vend-zhvarrimin Batajnica, në afërsi të Aeroportit të Beogradit²⁹. KNPZH, përmes sistemit të laboratorit të ADN-së me kapacitet të lartë arriti të bënte 700 identifikime të mbetjeve të zhvarrosura në Batajnicë. KNPZH gjithashtu ofroi asistencë teknike edhe në dy vend zhvarrime tjera në Serbi në vitin 2001, një afër Petrovo Selo³⁰, dhe një tjetër afër Bajina Basta³¹. Deri në vitin 2006, KNPZH ndihmoi autoritetet Serbe për të identifikuar 822 persona nga këto tre vend varrime duke përdorur metodat shkencore.

Në nëntor të vitit 2001, UNMIK-u dhe Republika Federale e Jugosllavisë (Serbia dhe Mali i Zi) nënshkruan Dokumentin e Përbashkët UNMIK-RFJ i cili rinovoj përkushtimin e të dyja palëve për të zgjidhur fatin e atyre të cilët ishin viktimat të zhdukjes me forcë dhe rrëmbimeve. Në shkurt të vitit 2002, UNMIK-u dhe RFJ nënshkruan protokollin për vendosjen e marrëdhënieve në mes të dy palëve për ri-atdhesimin përtej kufirit të mbetjeve të identifikuara njerëzore.³² Procesi i kthimit të këtyre mbetjeve tek familjet në Kosovë filloi në vitin 2003.

Në Serbi, Dhoma e specializuar për krimet e luftës e Gjykatës së Qarkut në Beograd dhe Zyra e prokurorit për krime të luftës u krijuan në korrik 2003³³ me ndihmën dhe mbështetjen e komunitetit ndërkombëtar. Para kësaj, vetëm një numër i vogël i individëve ishte ndjekur penalisht dhe gjykuar për krime lufte në Serbi. Që atëherë, Prokuroria për krime të luftës të Serbisë ka qenë përgjegjëse për hetimin dhe urdhërimin e gërmimit të varrezave klandestine në territorin e Serbisë.

Në vitin 2004, Fondi për të Drejtën Humanitare me seli në Beograd, në bazë të informacioneve të marra nga burime të shumëfishta të pavarura, publikoi informacionin se mbetjet njerëzore nga konflikti në Kosovë ishin asgjësuar në dy raste, me 16 dhe 24 maj të vitit 1999, në fabrikën e aluminit në Mackatica (afër Surdulicës) në Serbinë Jugore. Në prill të vitit 2005, atëherë Prokurori për Krime Luftë në Serbi Vladimir Vukcevic, shkoi në fabrikën e Mackatica së bashku me gjyqtarin hetues në Vranje dhe me një ekip mjejekeo-ligjor. Ata ekzaminuan të gjitha shpërthimet në fabrikë dhe të gjitha vendet ku gjenden mbeturinat minerare. Rezultatet e

²⁸ Në raportin e vitit 2013 të Komitetit të OKB-së për zhdukjet me forcë, Serbia ka raportuar se 1,296 mbetje mortore ishin zhvarrosur, nga të cilat 846 ishin persona të zhdukur nga konflikti në Kosovë. Një grup shtesë prej 53 mbetjeve mortore të personave të zhdukur nga konflikti në Kosovë u zhvarrosën në vitin 2014 nga varreza Raska Rudnicës.

²⁹ KNPZH, Raporti Përmbledhës për Batajnicën, 2004, faqe 5.

<http://www.KNPZH.int/wp-content/uploads/2014/08/KNPZH-fsd-16-04-2-doc.pdf>.

³⁰ Zhvarrimet në Serbi, 2001 PËRMBLEDHJE, 2002, FAQE 5.

<http://www.icmp.int/?resources=exhumations-in-serbia-2001-summary>.

³¹ *Ibid.*

³² Amnesty International, *Burying the Past: Impunity for enforced disappearances and abductions in Kosovo*, June 2009, p.19.

³³ *Ligji për Organizimin dhe Juridiksionin e Autoriteteve Qeveritare në Procedimet e Krimeve të Luftës* (Gazeta Zyrtare e Republikës së Republikës së Serbisë, No. 67/2003, 135/2004, 61/2005, 101/2007 dhe 104/2009).

“PËRKRAHJE PËR ZGJIDHJEN E RASTEVE TË PERSONAVE TË ZHDUKUR – THYERJA E NGËRÇIT”

hetimit të udhëhequr nga Shefi i Prokurorisë për Krime Luftë në lidhje me pretendimet e ngritura nga Fondi për të Drejtën Humanitare nuk janë bërë publike asnjëherë.³⁴

Në qershor të vitit 2006, Qeveria e Republikës së Serbisë ka formuar Komisionin Qeveritar të Serbisë për Persona të Zhdukur (KQPZH), me një mandat për të zgjidhur çështjen e personave të cilët janë zhdukur gjatë konflikteve të armatosura në territorin e ish-Jugosllavisë. Komisioni serb mori të gjitha aktivitetet dhe obligimet e Komisionit të Këshillit të Ministrave për persona të zhdukur të Serbisë dhe Malit të Zi, i formuar në vitin 2003, aktivitetet e vazhdueshme të organeve të mëparshme qeveritare, të formuara nga viti 1991, që kanë të bëjnë me çështjen e personave të zhdukur, burgosur dhe personat e vrarë në konfliktet në territorin e ish-Jugosllavisë.

Në vitin 2013, në bazë të një urdhri të Gjykatës së Qarkut të Beogradit, KQPZH e Serbisë koordinoj një seri hetimesh në një gurore të braktisur, në një vend të njohur si Rashka/Rudnica, dy kilometra në veri të kufirit me Kosovën. Këto hetimet çuan në zbulimin e një varreze të jashtëligjshme - e para në Serbi që nga zbulimi i vend-varrimeve në Batajnica, Petrovo Selo dhe Bajina Basta. Gërmimi filloi në prill të 2014. Pesëdhjetë e dy raste të mbetjeve mortore u zbuluar nga vendi nga një ekip i përbërë nga ekspertë të disa agjencive të përbërë nga ekipet Mjekoligjore Serbe dhe DML e EULEX, nën urdhër të Gjykatës së Qarkut në Beograd. KNPZH përfundoi analizat e ADN-së të të gjitha mostrave post-mortem të dorëzuara, e cila rezultoi në identifikimin e 52 personave të zhdukur nga konflikti në Kosovë. Vetëm një profil unik post-mortem nga mbetjet njerëzore të cilat janë zbuluar nga vend-varrimi Raska-Rudnica nuk korrespondon me asnjë nga referencat gjenetike në bazën e të dhënave KNPZH-së.

Përkundrajt përpjekjeve nga ana e Komisionit të Serbisë për Personat e Zhdukur, qll nga nëntori i vitit 2015 për të gjetur varrezat të jashtëligjshme në guroren e braktisur Kizevak në Serbinë Jugore, Në Serbi nuk janë zbuluar varreza të jashtëligjshme që nga viti 2014.

VI. LEGJISLACIONI

Kushtetuta e Kosovës përfshin instrumentet kryesore ndërkombëtare të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), dhe gjykatat e Kosovës zbatojnë ligjin e KEDNJ. Në bazë të KEDNJ-së, familjarët e personave të zhdukur kanë të drejtë në informacion në lidhje me fatin dhe vendndodhjen e të afërmeve të tyre, e cila është ankoruar në nenet 2, 3, 5 dhe 8 të KEDNJ-së. Autoritetet e Kosovës janë të detyruara, në përputhje me rrethanat, të ndërmarrin të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të siguruar një informacion të tillë.

Legjislacioni i brendshëm që përcakton të drejtat e familjeve të personave të zhdukur dhe detyrimet e shtetit është vendimtar për një proces të plotë të bazuar në sundimit e ligjit për gjetjen e personave të zhdukur pas konfliktit.

Kuvendi i Kosovës miratoi *Ligjin e Kosovës për Persona të Zhdukur* (Nr.03 / L-023), më 31 gusht 2011. Ky ligj është publikuar në gazetën zyrtare më 14 shtator 2011 dhe hyri në fuqi 15 ditë më vonë. Ligji ka për qëllim të mbrojë të drejtat dhe interesat e personave të zhdukur dhe familjarëve të tyre, në veçanti të drejtën e anëtarëve të familjes të dinë për fatin e personave të cilët janë raportuar të zhdukur gjatë periudhës 1 janar 1998 - 31 dhjetor 2000 si pasojë e luftës

³⁴ Humanitarian Law Center, *The cover-up of evidence of crimes during the war in Kosovo: THE CONCEALMENT OF BODIES OPERATION*, 2017, p 53-54.

“PËRKRAHJE PËR ZGJIDHJEN E RASTEVE TË PERSONAVE TË ZHDUKUR – THYERJA E NGËRÇIT”

në Kosovë gjatë viteve 1998-1999. Ai gjithashtu përcakton kompetencat dhe përgjegjësitë e Komisionit të Kosovës për Personat e Zhdukur.

I bazuar dukshëm në ligjin e B dhe H për personat e Zhdukur, Ligji i Kosovës përcakton personin e zhdukur, mishëron të drejtën e familjeve për të ditur për fatin e të afërmeve të tyre të zhdukur, riafirmon mandatin dhe kompetencat e KQPZH të Kosovës, të cilat janë përcaktuar më parë në vendimin e UNMIK-ut/IPVQ-të datës 6 tetor 2006 dhe ngarkon KQPZH të krijoj Regjistrin Qendror të personave të zhdukur.

Pas miratimit të *Ligjit të Kosovës për Personat e Zhdukur* në gusht të vitit 2011, Qeveria e Kosovës ka miratuar Rregulloren e punës së Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, e cila përcakton rregullat dhe procedurat e KQPZH të Kosovës dhe detyrat dhe përgjegjësitë e Njesisë administrative të Komisionit.

Ka megjithatë tre boshllëqe në drejtim të zbatimit të plotë të *Ligjit për personat e zhdukur*. Së pari, aktet nënligjore (rregulloret) për ndërprerjen e kërkimi nuk janë propozuar nga Ministria e Drejtësisë dhe miratuar nga Qeveria. Në bazë të *Ligjit për Personat e Zhdukur* kërkimi për personin e zhdukur konsiderohet i përfunduar kur personi i zhdukur është gjetur apo mbetjet e tij/saj mortore janë identifikuar. Këto akte nënligjore duhet të përcaktojnë se cilat institucione janë përgjegjëse për procedurat e ndryshme në lidhje me përfundimin e kërkimit, kush zyrtarisht e bën identifikimin ligjor, cili është roli i prokurorit, dhe kush duhet të informojë familjen kur çështja është e mbyllur. Këto akte nënligjore janë të nevojshme për të përcaktuar se cilat institucione janë përgjegjëse për procedurat e ndryshme të përfundimit të kërkimit, kush zyrtarisht përmbyllë identifikimin ligjorë, cili është roli i prokurorit dhe se kush duhet të informojë familjen kur rasti mbyllet. Së dyti, *Ligji për Persona të Zhdukur* parashikon se Zëvendës Kryesuesi i KQPZH të Kosovës duhet të jetë një përfaqësues i komuniteteve jo-shumicë. Megjithatë, që nga viti 2011, kur zëvendës kryesuesi i Komisionit nga komunitetet jo-shumicë dha dorëheqjen, pozita ka qenë bosh. Së treti, KQPZH i Kosovës ende nuk ka miratuar një rregullore që do të vendosë procedurën për përdorimin, regjistrimin, përjashtimin dhe shkëmbimin e të dhënave, duke përfshirë verifikimin dhe menaxhimin e tyre. *Ligji për Personat e Zhdukur*, në bazë të nenit 15 ngarkon KQPZH-në e Kosovës të miratojë një rregullore të tillë në bazë të *Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale* dhe *Ligjit për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë dhe rregullat e sigurisë*, si dhe detyrimet e tjera ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dhënave personale.

Ndërsa pjesë të *Ligjit për Personat e Zhdukur* nuk janë zbatuar plotësisht, një shqetësim më i madh është mbivendosja e mandatit të Institutit të Mjekësisë Ligjore, të përcaktuar me *Ligjin për Mjekësi Ligjore*, me mandatin dhe kompetencat e KQPZH të Kosovës, i cili është përcaktuar me *Ligjin për Personat e Zhdukur*. Neni 15 Paragrafi 1.7 përcakton se Instituti i Mjekësisë Ligjore do të mbajë "kontakte me familjet e personave të zhdukur dhe bashkëpunon me institucionet dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare të përfshira në procesin e zbardhjes së fatit të personave të zhdukur". Kjo është në kundërshtim me mandatin e KQPZH të Kosovës të përcaktuar me nenin 8 të *Ligjit për Personat e Zhdukur*, i cili thotë se KQPZH i Kosovës "mbikëqyr, harmonizon dhe koordinon aktivitetet me institucionet vendore dhe ndërkombëtare, bashkëpunon me institucionet dhe organizatat ndërkombëtare dhe aktorët e tjerë në lidhje me zbardhjen e fatit të personave të zhdukur si pasojë e luftës së viteve 1998-1999".

Autoritetet e Kosovës kanë marrë masa për të siguruar që familjet e personave të zhdukur kanë të drejtat e qasjes dhe përfitimet sipas ligjit. Megjithatë, anëtarët e familjeve të luftëtarëve të zhdukur kanë trajtim preferencial vis-à-vis familjeve të civilëve të zhdukur.

“PËRKRAHJE PËR ZGJIDHJEN E RASTEVE TË PERSONAVE TË ZHDUKUR – THYERJA E NGËRÇIT”

Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për *Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave të dhunës seksuale të luftës, viktimave civile dhe familjeve të tyre* (Nr.04 / L-054) në dhjetor 2011. Sipas Ligjit anëtarët e familjeve të zhdukurve³⁵ realizojnë të drejtat dhe përfitimet e mëposhtme: pension familjar; Kujdes shëndetësor falas në institucionet publike të kujdesit primar dhe sekondar shëndetësor; Përrjashtimi nga tatimi në pronë, nëse familja është në rrethana të vështira ekonomike; dhe shpenzime të reduktuara të energjisë elektrike për përdorim personal, në qoftë se familja është në rrethana të vështira ekonomike dhe i plotëson kriteret e përcaktuara në skemën e ndihmës sociale.

Anëtarët e familjeve të ushtarëve të zhdukur të UÇK, përveç kësaj mund të pretendojnë të drejtat dhe përfitimet e mëposhtme: të drejtën për pension familjar; përparësi në punësim; përparësi në regjistrimin dhe pranimin në institucionet arsimore publike; bursa për arsimin e mesëm dhe universitar; strehim të lirë në konviktet e studentëve; mbështetje për strehim familjar; tarifa e lirë dhe të reduktuar të konsumit të energjisë elektrike për përdorim personal në rast të rrethanave të vështira ekonomike, kur edhe ndihmë të plotë sociale; Lirimi nga pagesa e gjykatës, administrative dhe tarifat publike; kujdes shëndetësor falas në institucionet publike shëndetësore të nivelit parësor, dytësor dhe terciar; strehim falas në shtëpitë për të moshuarit; dhe përjashtimi nga pagesat administrative në arsimin e lartë publik.

Ndryshe nga Kosova apo Bosnja dhe Hercegovina, Serbia nuk ka asnjë ligj për personat e zhdukur, i cili do të rregullonte statusin e personave të zhdukur dhe të përcaktojë të drejtat e familjeve të personave të zhdukur. Hetimin rasteve të personave të zhdukur në Serbi është ndërmarrë si pjesë e përpjekjeve të përgjithshme për të hetuar krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit, në përputhje me *Kodin Penal të Serbisë* dhe *Kodit të Procedurës Penale*, si dhe *Ligjit mbi Organizimin dhe Juridiksionin e Autoriteteve Qeveritare në procedurat për krimet e luftës*.

Serbia ka miratuar *Ligjin për Invalidët Civil të Luftës*. Ky ligj, megjithatë, është problematik në zbatimin aty ku familjet e personave të zhdukur janë të shqetësuar. Të drejtat që ligji parashikon për viktimat civile dhe familjet e tyre mund të ndahen në tre grupe: (1) kompensim monetar; (2) shëndetësor dhe (3) çmime të reduktuara të biletave të transportit publik. Sipas nenit 3 të ligjit: "anëtar i familjes së viktimës së luftës është konsideruar të jetë një anëtar i familjes së një personi i cili u vra ose ka vdekur [...]; nëse anëtari i familjes ka jetuar në një familje të përbashkët me personin e lartpërmendur, para vdekjes së tyre."³⁶

Sipas Ligjit, viktimat e zhdukjeve me forcë nuk konsiderohen të jenë viktimat civile të luftës. Në mënyrë që të kenë qasje në të drejtat e tyre sipas Ligjit, këto familje janë të detyruara të deklarojnë anëtarin e tyre të zhdukur të familjes si të vdekur. Shumë familje refuzojnë të deklarojnë të dashurit e tyre të vdekur derisa mbetjet e tyre mortore nuk janë gjetur dhe rrethanat e zhdukjes së tyre me forcë nuk janë përcaktuar.

³⁵ Bashkëshorti, fëmija, prindërit, njerku, njerka, fëmija, fëmija i adoptuar ose partneri jashtëmartesor i personit të zhdukur konsiderohen anëtarë të familjes së personave të zhdukur sipas *Ligjit për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës, Viktimat Civile dhe Familjet e tyre*. Bashkëshorti i një personi të zhdukur humbet të drejtën për përfitime financiare të parapara me ligj nëse ai ose ajo martohet. Fëmija i një personi të zhdukur ka të drejtën e përfitimeve financiare sipas ligjit deri në moshën tetëmbëdhjetë vjeç ose deri në moshën njëzet e gjashtë nëse janë të regjistruar në arsimin e lartë.

³⁶ *Ligji për Invalidët Civil të Luftës, Neni. 3 ("Gazeta Zyrtare e RS", No. 52/96).*

“PËRKRAHJE PËR ZGJIDHJEN E RASTEVE TË PERSONAVE TË ZHDUKUR – THYERJA E NGËRÇIT”

Për më tepër, ligji specifikon që anëtarët e familjes kanë të drejtë në reparacione administrative, dhe kjo përcakton një kusht shtesë, se ata "kanë jetuar në një familje të përbashkët" para vdekjes së viktimës. Anëtarët e njohur të familjes janë: bashkëshorti, fëmijët (të lindur brenda ose jashtë martese, të birësuar apo njerkë) dhe prindër. Ligji përjashton vëllezërit e motrat e viktimave, por edhe fëmijët dhe prindërit në rastet kur ata nuk jetojnë në të njëjtën familje.

VII. FAMILJET E TË ZHDUKURVE

Familjet e të zhdukurve kanë një rol thelbësor në procesin e kërkimit për personat e zhdukur pas konfliktit. Jo vetëm që është angazhimi i familjeve të personave të zhdukur i nevojshëm për një proces të identifikimit të udhëhequr nga ADN të bazuar në përputhjen e farefisnisë, ajo është po aq e rëndësishme sa i përket mbajtjes së autoriteteve përgjegjëse në lidhje me kërkimin për, dhe identifikimin e personave të zhdukur.

Si kudo në Ballkanin Perëndimor, edhe në Kosovë, KNPZH ka inkurajuar pjesëmarrjen aktive të familjeve të personave të zhdukur në këtë proces. E ka bërë këtë nëpërmjet edukimit, trajnimit dhe programet e granteve që synojnë fuqizimin e shoqatave të familjeve të personave të zhdukur, dhe përmes një procesi të ndërtimit të mirëkuptimit të ndërsjellët përmes dialogut në mes të një grupi të vogël të drejtuesve të shoqatave të familjeve të serbëve të zhdukur dhe familjarëve të shqiptarëve të Kosovës. Kjo iniciativë ka qenë e vazhdueshme që nga konflikti në Kosovë. Ajo ka theksuar nevojën për bashkëpunim më të madh dhe mirëkuptim në mes të shoqatave të familjeve të personave të zhdukur dhe nevojën për avokim të përbashkët dhe koordinim në mes grupeve të ndryshme për të zgjidhur problemet e përbashkëta në adresimin e çështjes së të zhdukurve.

Përparimi drejt mirëkuptimit të ndërsjellët dhe identifikimi ndërmjet anëtarëve të familjeve ka qenë i konsiderueshëm. Disa shoqata të familjeve të personave të zhdukur njohin vlerën e punës së bashku, dhe duke folur me një zë të përbashkët ata janë më të aftë për të përfituar objektiva të politikave dhe të shtypin procesin e personave të zhdukur përpara. Ata kanë marrë pjesë në takimet bilaterale me institucione që punojnë në çështjen e personave të zhdukur dhe kanë bërë kërkesa të përbashkëta për përgjigjet që kanë të bëjnë me procesin e gjetjes, zhvarrimit dhe identifikimit të personave të zhdukur. Ata kanë ndjekur këto kërkesa dhe kanë synuar të sigurohen se shtetet respektojnë angazhimet e tyre. Ata kanë filluar edhe për të shënuar Ditën Ndërkombëtare të të Zhdukurve, mbajtjen e njëkohshme të konferencave të përbashkëta për shtyp në Beograd dhe në Prishtinë, që përfshin një grup të përzier të shoqatave familjare serbë dhe shqiptarë të Kosovës.

KNKK dhe organizatat e Kryqit të Kuq, gjithashtu kanë ofruar përkrahje të rëndësishme për familjet e personave të zhdukur në Kosovë dhe Serbi si dhe në të gjithë rajonin. KNKK ka përkrahur rregullisht projektet psiko-sociale, shpesh të zbatuara nga organizata vendore të Kryqit të Kuq. KNKK gjithashtu, ka mbajtur punëtorë në të gjithë rajonin, për të përcjellë nevojat e familjeve tek autoritetet, mediat dhe tek shoqëria në tërësi. Qëllimi primar i organizatave të Kryqit të Kuq është ti shoqërojë familjet gjatë kërkimit, identifikimit dhe mbylljes së rasteve të personave të zhdukur.³⁷

Megjithatë, 17 vjet të kërkimit për të zhdukurit dhe kërkimit të përgjigjeve nga autoritetet, shumë familje janë tej lodhur dhe kanë frikë se të afërmit e tyre nuk do të gjenden asnjëherë.

³⁷ Artikull i KNKK, *Personat e Zhdukur në Ballkanin Perëndimor*, 2 June 2015, https://www.icrc.org/en/resource-centre/result?f=document_type%3A%22Article%22&sort=date+desc.

“PËRKRAHJE PËR ZGJIDHJEN E RASTEVE TË PERSONAVE TË ZHDUKUR – THYERJA E NGËRÇIT”

VIII. SISTEMET E TË DHËNAVE

Sistemet e fuqishme të dhënave janë të domosdoshme për procesin e gjetjes së një numri të madh të personave të zhdukur pas konfliktit ose abuzimeve të të drejtave të njeriut. Aplikacione të fuqishme të integruara të cilat përkrahin proceset e ruajtjes, shikimit dhe analizimit një mase të madhe të dhënash nuk janë vetëm çelësi për të siguruar transparencën dhe menaxhimin e mirë të procesit të gërmimit dhe identifikimit por ato gjithashtu mund të ndihmojnë në përdorimin e të dhënave për të identifikuar trajtat e zhdukjes dhe gërmimit të cilat më tej mund të ndihmojnë përpjekjet e kërkimit. Përveç kësaj, sistemi i fuqishëm i të dhënave është thelbësorë për të ju mundësuar familjeve të të zhdukurve të regjistrojnë të afërmit e tyre të zhdukur, i cili shpesh mund të jetë parakusht për përfitimin e kompensimeve dhe dëmshpërblimeve ekonomike nga autoritetet.

KNKK-ja ishte ndër organizatat e para që mbledhur të dhëna për persona të zhdukur në lidhje me konfliktin e Kosovës. KNKK ka filluar hartimin e një liste të të zhdukurve në Kosovë, në janar të vitit 1998 në bazë, ndër të tjera, të kërkesave për gjurmim - kërkesave të paraqitura nga njerëz që raportojnë se anëtarët e familjeve të tyre ishin zhdukur³⁸. Në prag të konfliktit të viteve 1998-99 dhe pas tij, lista përfshinte 6,049 emra. Nga këto raste, 1372 u pas gjetën të gjallë³⁹. Në bazë të kërkesave të tij për gjurmim, KNKK ka mbajtur një listë të përkohshëm të personave të zhdukur, të rënë dakord nga delegacionet e Beogradit dhe Prishtinës të Grupit Punues, dhe ofron versione të reja rregullisht për të dyja palët.

Ligji për Personat e Zhdukur (neni 13) thekson se KQPZH i Kosovës do të krijojë dhe mirëmbajë një Regjistër Qendror të Personave të Zhdukur. Kjo është një bazë të dhënash që përfshin të dhënat për personat e zhdukur të mbledhura nga burimet e disponueshme për të ndihmuar në zbulimin e identitetit dhe vendndodhjes, si dhe rrethanat e zhdukjes së personave të zhdukur. *Ligji për Persona të Zhdukur* detyron KQPZH të Kosovës me mbledhjen dhe centralizimin e të dhënave mbi personat e zhdukur në regjistrin e tij qendror. Të dhënat duhet të mbledhen nga të gjitha burimet në dispozicion.

KQPZH i Kosovës krijoi Regjistrin Qendror në vitin 2012. Ai është i vendosur në ambientet e Ministrisë së Administratës Publike. Përmban të dhënat për 1,764 raste të hapura të personave të zhdukur. KQPZH i Kosovës përfshiu edhe të dhënat post-mortem të 558 rasteve të identifikuar të personave të zhdukur në Regjistrin Qendror. Për shkak të mungesës së burimeve njerëzore, ai nuk ka përfshirë edhe të dhënat e rreth 3.000 rasteve të mbyllura. Informacioni mbi rastet e mbyllura është në posedim të IML (Ministria e Drejtësisë). Regjistri qendror është i arritshëm për familjet e personave të zhdukur të përcaktuara me *Ligjin për Persona të Zhdukur* (neni 14). Anëtarët e familjes ose përfaqësuesit e tyre ligjor mund të paraqesin një kërkesë për të hyrë në të dhënat në Regjistrin qendror të KQPZH të Kosovës, i cili është i detyruar të shqyrtojë kërkesën dhe merr vendim brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga marrja e kërkesës. Në kohën e shkrimit të këtij raporti, Regjistri qendror nuk është i disponueshëm online. Duhet të bëhen përpjekje për të siguruar përfundimin e Regjistrit Qendror për të përfshirë të gjitha rastet e mbyllura dhe rastet e hapura kohët e fundit, dhe për ta bërë atë të disponueshëm online. Autoritetet e Kosovës duhet të sigurojnë që KQPZH-së ka kapacitet teknik për të ruajtur dhe për të menaxhuar të dhënat në Regjistrin Qendror.

³⁸ Artikull i KNKK, Personat e Zhdukur në Ballkanin Perëndimor, 2 qershor 2015, https://www.icrc.org/en/resource-centre/result?f=document_type%3A%22Article%22&sort=date+desc.

³⁹ Gjithsej 34,891 njerëz janë raportuar tek KNKK si të zhdukur në lidhje me konfliktet e viteve 1990.

“PËRKRAHJE PËR ZGJIDHJEN E RASTEVE TË PERSONAVE TË ZHDUKUR – THYERJA E NGËRÇIT”

KNKK ka qenë energjik në asistimin e Komisionit të Kosovës për Personat e Zhdukur për të ndihmuar atë të përmbushë detyrimet e tij sipas Ligjit për Personat e Zhdukur për të krijuar Regjistrin Qendror. Pas një kërkesë nga Komisioni i Kosovës për Persona të Zhdukur, KNKK dhe Komisionin e Kosovës për Persona të Zhdukur në qershor të vitit 2012 nënshkruan marrëveshjen për Dorëzimin e Softuerit për bazën e të dhënave post-mortem/ante-mortem⁴⁰.

KNPZH ka ndihmuar autoritetet në Kosovë dhe në Serbi duke ju ofruar atyre qasje në Sistemin e Menaxhimit të të dhënave identifikues (iDMS). IDMS është një zgjidhje e specializuar softuerike e zhvilluar nga KNPZH për të menaxhuar programet e personave të zhdukur në shkallë të gjerë. Ajo ka një grup të aplikacioneve të fuqishme të integruara që mbështet procesin e ruajtjes, analizimit dhe shkëmbimit të një sasive shumë të mëdha të të dhënave për personat e zhdukur, hetimet, dhe identifikimet. Në bazën e të dhënave iDMS janë të përfshira 4,415 raste të personave të zhdukur nga konflikti në Kosovë, si dhe profilet e të afërmeve të mbijetuar.⁴¹ Autoritetet në Kosovë dhe Serbi mund të kenë qasje në këto të dhëna përmes Qendrës së Kërkimit Online (QKO) të KNPZH e cila është një platform online për iDMS.⁴²

Rritja e bashkëpunimit rajonal midis vendeve të Ballkanit Perëndimor është vendimtar në procesin e kërkimit dhe identifikimit të të zhdukurve. Një komponent kyç i bashkëpunimit rajonal është shkëmbimi transparent i të dhënave për personat e zhdukur. ICMP është duke negociuar dhe duke lehtësuar krijimin e një baze të dhënash të rasteve aktive të personave të zhdukur nga konfliktet e armatosura në ish-Jugosllavi, duke përfshirë konfliktin e Kosovës, si një bazë të integruar të personave të cilët janë zhdukur në mes të 1991 dhe 2000, si rezultat i konflikteve. Baza e përbashkët e të dhënave do të përfshijë të dhënat zyrtare të personave të zhdukur të Bosnjës dhe Hercegovinës, Kroacisë, Kosovës, Malit të Zi, Serbisë dhe KNPZH mungojnë. Baza e të dhënave do të mbështesë procesin e kërkimit për të zhdukurit në rajon, jo më pak për sa i përket edhe konfliktit të Kosovës me: a) marrjen e të dhënave të vazhdueshme live në dispozicion, e cila përbën të dhënat e sakta të rasteve aktive të personave të zhdukur dhe numrat e tyre të përgjithshëm; b) duke siguruar transparencë më të madhe në hapjen dhe mbylljen e rasteve; c) duke trajtuar çështjen e të dhënave të dyfishuara të personave të cilët janë raportuar të zhdukur në më shumë se një vend; dhe d) duke lehtësuar shkëmbimin e të dhënave që KNPZH ka në pronësi të tij për rastet e personave të zhdukur, që janë regjistruar në

⁴⁰ Artikull nga KNKK, Personat e Zhdukur në Ballkanin Perëndimor, 2 qershor 2015,

https://www.icrc.org/en/resource-centre/result?f=document_type%3A%22Article%22&sort=date+desc.

⁴¹ iDMS përfshinë të dhënat e më shumë se 150,000 personave të mbledhura nga KNPZH gjat punës së tij në mbarë globin.

⁴² Ka një shkallë të lartë të kontrollit mbi qasjen në informatat e ndjeshme, të tilla si të dhënat e ADN-së dhe familjare. Çdo përdorues ka qasje vetëm në pjesë të autorizuar të dhënave, dhe të dhënat e ndjeshme është ruajtur dhe analizuar në një formë anonime, të koduar në shumë faza të procesit. Sikur është vënë në dukje në raportin e KNPZH të vitit 2014: *Bosnja dhe Hercegovina, Personat e Zhdukur nga konfliktet e armatosura të viteve 90: Vlerësimi i gjendjes*, në përgjithësi në fushën e përpunimit të të dhënave personale, duke përfshirë të dhëna gjenetike, interesat dhe mirëqenia e individit duhet të ketë prioritet mbi të drejtat dhe interesat e shoqërisë. Mbledhja, përdorimi dhe ruajtja e të dhënave gjenetike të njeriut prandaj duhet të jetë në përputhje me parimet e pëlqimit të shprehur, konfidencialitetit dhe anonimitetit të të dhënave personale gjenetike. Të dhënat gjenetike duhet në veçanti të mos zbulohen ose të bëhen të arritshme për palë të treta (punëdhënësit, kompanitë e sigurimeve, institucionet arsimore apo familjen), përveç në rastet e një interesi bindës publik të parashikuar në bazë të ligjit. Pjesëmarrja e anëtarëve të familjes në proceset e udhëhequr me ADN për këtë arsye është vullnetare dhe i nënshtrohet pëlqimit të tyre. Pëlqimi i shprehur do të thotë se familjet janë të informuara paraprakisht për përdorimet që do tu bëhen të dhënave të tyre. Formularët e miratimit të përdorura nga KNPZH në Kosovë dhe Serbi ju mundëson familjeve të deklarohen se informacioni personal gjenetik dhe të tjerë do të përpunohen vetëm për qëllime të identifikimit. Në veçanti, përdorimi i të dhënave personale, duke përfshirë të dhëna gjenetike si provë në gjykimet penale, përbën një përdorim të ndryshëm. Politikat e KNPZH përcaktojnë, pra, që palët në gjykimet penale, pra prokuroria ose mbrojtja, që dëshirojnë të kenë qasje në provat e ADN-së duhet të përcaktojnë rastet individuale të personave të zhdukur, dhe individët në pyetje duhet të ofrojnë pëlqimin e tyre të shprehur për përdorimin e të dhënave të tyre në gjykatë. Forma e dhënies së pëlqimit për ADN në përdorim sot në Kosovë dhe Serbi lejojnë anëtarët e familjes për të vendosur në kohën e dhënies së informacionit personal nëse të dhënat e tyre mund të përdoren për qëllime të ndjekjeve penale.

“PËRKRAHJE PËR ZGJIDHJEN E RASTEVE TË PERSONAVE TË ZHDUKUR – THYERJA E NGËRÇIT”

QKO të KNPZH-së, por që mund të mos jenë regjistruara në regjistrat e personave të zhdukur të autoriteteve të Kosovës dhe Serbisë.

Në qershor të vitit 2016, Kosova ka pranuar të marrë pjesë në projektin e KNPZH të "bazës së të dhënave të rasteve të hapura të personave të zhdukur nga konfliktet e armatosura në ish-Jugosllavi", duke përfshirë edhe furnizimin e KNPZH me të dhënat e saj mbi rastet e hapura të personave të zhdukur për t'u përfshirë në bazën e të dhënave, të cilat do të bëhen të arritshme dhe të kërkueshme nga autoritetet e Kosovës, si dhe nga autoritetet në Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci, Mal të Zi dhe Serbi në bazë të asaj që këto autoritete në mënyrë reciproke do të sigurojnë të dhënat e tyre respektive për rastet e hapura të personave të zhdukur.

IX. SHKENCA DHE TEKNOLOGJIA

Që nga viti 2001 në Serbi dhe që nga viti 2003 në Kosovë, KNPZH ka ndihmuar autoritetet duke ofruar procesin e identifikimit të personave të zhdukur të udhëhequr nga ADN. Procesi i identifikimit i udhëhequr nga ADN siç aplikohet në Kosovë, përbëhet nga përputhja e profileve të ADN-së nga mbetjet skeletore me profileve e ADN-së nga anëtarët e familjeve të të zhdukurve. Prandaj, aftësia për të bërë identifikime të bazuara në ADN varet nga mbledhja e sasive të mjaftueshme të ADN-së nga mostrat skeletore si dhe në mbledhjen e mostrave gjenetike nga të afërmit, të një numri dhe llojit të mjaftueshëm për të lejuar përputhjet e ADN që duhen bërë. Sistemi i identifikimit me ADN i KNPZH ka një kontroll të lartë cilësie dhe që nga viti 2007 është akredituar ndërkombëtarisht me standardet ISO 17025.

Shkencëtarët në Laboratorin e ADN-së të KNPZH analizojnë mostrat e gjakut, kockave dhe dhëmbëve me qëllim të nxjerrjes së një profili të ADN-së nga çdo referencë dhe mostër post-mortem. Sikurse mostrat referente, mostrat skeletore post-mortem gjurmohen dhe përpunohen në laboratorin e ADN-së me një bar kod të verbër identifikues. Pastaj, profilet e ADN-së nga mostrat skeletore parashtrihen për përputhje. Lloji i testimit të ADN-së që përdor KNPZH është përsëritja e tandemëve të shkurtra (STR) testimi i ADN-së nukleare me testimin STR të Y kromozomeve i cili aplikohet në raste të veçanta kur konsiderohet i domosdoshëm për arritjen e përputhjes familjare.

KNPZH fut të gjitha informacionet nga profilet e referencave gjenetike dhe profilet post-mortem në sistemin e tij të bazave të dhënash. Softueri i posaçëm për përputhje i dizajnuar nga KNPZH, pastaj analizon profilet e ADN-së lidhjet e mundshme farefisnore, si, por jo vetëm, prindër/fëmijë, fëmijë/fëmijë. Çdo përputhje e mundshme kontrollohet dy herë duke përdorur një softuer të veçantë për të siguruar saktësinë e lidhjeve familjare

Nëse gjendet përputhja, e cila është e barabartë ose kalon pragun prej 99.95 për qind të probabilitetit statistikor të identitetit, atëherë lëshohet Raporti i Përputhjes së ADN-së. Çdo raport i nënshtrohet një procesi shqyrtimi të zgjeruar ku të gjitha informacionet të cilat i përmban raporti kontrollohen për qëndrueshmëri para se të lëshohet raporti tek autoritetet relevante. Edhe pse përputhja e ADN-së përmban shumë informacione për identitetin e një individi, IML bën identifikimin formal duke përdorur të dhënat tjera ante-mortem, dhe lëshon certifikatën e vdekjes.

Sikur u theksua më herët, në kontekstin e konfliktit të Kosovës, KNKK ka hartuar një listë prej 6,049 individësh, të bazuar në kërkesat për gjurmim të familjeve, e cila sipas raportimeve përfshinte edhe 1,371 persona të gjetur të gjallë ose të vizituar në burgje. Sot, numri i personave

“PËRKRAHJE PËR ZGJIDHJEN E RASTEVE TË PERSONAVE TË ZHDUKUR – THYERJA E NGËRÇIT”

akoma të zhdukur në listën e Grupit Punues është 1,665. Bazuar në mostrat referente të mbledhura nga familjet e të zhdukurve nga konflikti në Kosovë, KNPZH vlerëson se numri i përgjithshëm i personave të zhdukur nga konflikti në Kosovë është rreth 4,500.

Gjer më 31 dhjetor 2016, KNPZH ka mbledhur 14,810 mostra referente nga anëtarët e familjeve të cilët kanë raportuar të afërmit e zhdukur tek KNPZH. Këto mostra referente përfaqësojnë 4,415 persona të zhdukur.

KNPZH ka filluar të pranojë mostrat post–mortem nga autoritetet Serbe në qershor të vitit 2002 dhe nga UNMIK-u në vitin 2003. Deri në 31 dhjetor të vitit 2016 KNPZH ka pranuar nga ZPZHML e UNMIK-ut dhe EULEX-i si dhe autoritetet Serbe 7,207 mostra post-mortem për përpunim të ADN-së. Nga këto motra post–mortem, KNPZH ka nxjerrë 5,691 profile, nga të cilat 3,239 janë profile unike. Me fjalë të tjera, KNPZH ka nxjerrë profile të ADN-së nga mostrat post–mortem nga të cilat potencialisht mundë të bëjë përputhjen e ADN-së për jo më pak se 3,239 raste individuale të personave të zhdukur.

Sot, duke krahasuar 3,239 profile unike të cilat KNPZH i ka nxjerrë nga mostrat post –mortem, me profilet referente të 14,517 anëtarëve të familjeve, të cilët kanë raportuar të afërm të zhdukur, KNPZH ka arritur 2,539 përputhje të ADN-së. Kjo do të thotë se KNPZH ka ndihmuar autoritetet në Serbi dhe Kosovë të identifikojnë besueshëm 2,539 raste individuale të personave të zhdukur duke përdorur metodat moderne shkencore.


Megjithatë, përgjatë viteve numri i përputhjeve të ADN-së që përfaqësojnë identifikime të reja, ka rënë në mënyrë dramatike (figura ne. 2 shikoni më poshtë – ilustron trendin në kuptimin e arritjes së përputhjeve të reja të ADN-së). Rënja e numrit të identifikimeve të reja duhet të shihet në lidhje me numrin e rasteve të pazgjidhura të personave të zhdukur në listën e KNKK të personave të zhdukur në lidhje me ngjarjet në Kosovë; Deri në mars të vitit 2006, KNKK ka raportuar se kishte 2,389 raste të pazgjidhura⁴³, në prill të vitit 2010 kishte 1,862⁴⁴, dhe në dhjetor të vitit 2016 ishin 1,665 raste⁴⁵.

⁴³ Komunikatë për shtyp e KNKK, 06/10: Kosovë, KNKK shpreh keqardhje për përparimin e ngadaltë të grupit për personat e zhdukur, 09-03-2006.

⁴⁴ KNPZH, Situata në Kosovë – Vlerësimi i gjendjes, 2010.

⁴⁵ Të dhënat e ofruara me mirësjelljen e KNKK.

**“PËRKRAHJE PËR ZGJIDHJEN E RASTEVE TË PERSONAVE
TË ZHDUKUR – THYERJA E NGËRÇIT”**



*Figura 2:
Raportet unike të përputhjes së ADN-së të parashtruara sipas viteve*

KNPZH ka lëshuar pjesën dërmuese të raporteve të ADN-së (1,997) para vitit 2007 (78 për qind të numrit të përgjithshëm të raporteve përputhëse të ADN-së të personave të zhdukur). Që në vitin 2005, në raportin e parë të tij për Vlerësimin e Gjendjes në Kosovë, KNPZH kishte parashikuar shkallën e ulët të identifikimeve të reja e cila për fat të keq u vërtetua. Parashikimi i KNPZH bazohej në vlerësimin e numrit të madh të mostrave gjenetike që kishte mbledhur, numrin e madh të profileve që kishte arritur nga mostrat post – mortem dhe rrënjës së rëndësishme të gjetjes dhe zvarrosjes së varrezave të jashtëligjshme.

Grafiku 2 (shiko më poshtë) tregon numrin e personave të zhdukur të përfaqësuar me sete të plota të referencave familjare - sot 4,415 persona të zhdukur. Është shqetësuese se 1,876 nga këto sete nuk përputhen me asnjë nga 3,239 profilet unike që KNPZH i ka nxjerrë nga mostrat post – mortem. Me fjalë të tjera, familjarët e 1,876 personave të zhdukur janë duke pritur përgjigje për fatin e të afërmve të tyre të zhdukur.

**“PËRKRAHJE PËR ZGJIDHJEN E RASTEVE TË PERSONAVE
TË ZHDUKUR – THYERJA E NGËRÇIT”**




Figura 3:

Numri i personave të zhdukur të përfaqësuar me grupe të mbledhura të mostrave referente, Numri i grupeve të papërputhura

Sikurse u tha edhe më herët, që nga viti 2003, KNPZH ka pranuar nga OMPF e UNMIK-ut, EULEX-i dhe autoritetet Serbe 7,207 mostra post-mortem për përpunim dhe testim të ADN-së. Nga këto mostra post-mortem, KNPZH ka nxjerrë 5,691 profile gjenetike, nga të cilat 3,239 janë profile unike gjenetike që kanë të bëjnë me individë të vetëm. Gjer në vitin 2005, KNPZH përpunoi dhe profiloji pjesën dërmuese të mostrave të pranuar. Tabela më poshtë dëshmon numrin e profileve të reja unike të nxjerra përgjatë viteve nga mostrat post-mortem. Numri i profileve të reja unike post-mortem ka rënë në mënyrë dramatike që nga viti 2006. Shiko figurën 4 më poshtë.




Figura 4:

Numri i profileve unike post-mortem të nxjerra nga KNPZH në periudhën 2002-2016 (GJITHSEJ: 3,239)


Është me rëndësi të theksohet se gjatë kohës, dallimi në mes të mostrave të përpunuara post-mortem me profilet e reja unike të nxjerra është rritur në mënyrë alarmuese. Në periudhën 2002-2005, KNPZH ka nxjerrë profil unik post-mortem për çdo 1.4 mostra të përpunuara post-mortem. Në periudhën 2006-2010, KNPZH ka nxjerrë profil unik post-mortem për çdo 4.6 mostra post mortem të përpunuara, duke sugjeruar kështu se mostrat e pranuar më vonë kryesisht

“PËRKRAHJE PËR ZGJIDHJEN E RASTEVE TË PERSONAVE TË ZHDUKUR – THYERJA E NGËRÇIT”

kanë qenë pjesë të vogla të individëve për të cilët mostrat ishin parashtruar më herët. Në periudhën 2011-2016 KNPZH ka nxjerrë profil unik post-mortem nga çdo 5.4 mostra post mortem të përpunuara.

Arsyeja për rritjen e këtij dallimi është sepse që nga fundi i vitit 2006 shumica e mostrave të pranuar post mortem kanë qenë mostra skeletore të personave për të cilët KNPZH kishte nxjerrë profilin e ADN-së nga mostrat e parashtruara më herët post-mortem. KNPZH raporton këto raste si raste të ri-bashkimeve. KNPZH ka nxjerrë një numër të vogël të përputhjeve të reja të ADN-së (542 raporte të reja të ADN-së) dhe një numër të madh të raporteve të ri-bashkimit (1,417). KNPZH lëshon raport të ri-bashkimit në një mostër, për të treguar se përputhet me mostrat tjera të cilat janë parashtruar dhe identifikuar më herët. Kjo mundëson ri-bashkimin e pjesëve të shpërbëra të elementeve skeletore, që mund të ndodhë si rezultat i përzierjes së trupave në varreza të ndërlukuara os si rezultat i ri-zhvarrimeve të jashtëligjshme të mbetjeve njerëzore dhe bartjen e tyre në varreza dytësore, me rastet e identifikuar më herët ose me elementet skeletore të profiluar me ADN më herët për të cilët nuk ka identifikim me ADN. Shiko figurën 5 më poshtë.

Kjo shkallë në rritje e mostrave post-mortem në raport me profilet e reja unike tregon se gjatë dekadës së fundit shumica e mostrave post-mortem janë marrë nga mbetjet skeletore të gjetura në morgun e Prishtinës, nga të cilat në shumë raste janë marrë mostra disa herë nga institucione të ndryshme si ZPZHML e UNMIK-ut dhe EULEX-i. Kjo tregon gjithashtu se gjatë dekadës së fundit është gjetur dhe zhvarrosur një numër i vogël i varrezave të jashtëligjshme dhe me më pak zhvarrime dhe më pak raste të zhvarrosura dhe të mostruara, rezultati përfundimtar është rënja e rëndësishme e përputhjeve të reja të ADN-së dhe një numër i madh i ri-bashkimeve. Këto numra mbështeten edhe nga fakti se IML i EULEX-it raporton se në mes të viteve 2009-2016 janë zhvarrosur vetëm 232 trupa dhe 268 pjesë trupash nga ose me asistencën e IML të EULEX-it.



*Figura 5:
Raportet e dorëzuara të ri-bashkimeve, 2002-2016*

KNPZH merr mostra referente nga anëtarët e familjes të cilët japin të dhëna ante mortem në KNPZH për një të afërm të zhdukur, ose për të afërmit e zhdukur. Shumica e mostrave referente u siguruan me iniciativën e vetë anëtarëve të familjes. Në raste të tjera, KNPZH ju kërkua nga komisionet e Kosovës apo Serbisë për personat e zhdukur, ose ZPZHML e UNMIK-ut ose EULEX-it për t'u qasur anëtarëve të caktuar të familjes për të marrë mostra referente.

Në vitin 2010, KNPZH kishte referenca të plota referente për 1,860 individëve të pa identifikuarq:

“PËRKRAHJE PËR ZGJIDHJEN E RASTEVE TË PERSONAVE TË ZHDUKUR – THYERJA E NGËRÇIT”

sot ai numër është rritur në 1,876. Për më tepër, në raportin e vitit 2010 *për Vlerësimin e Gjendjes*, KNPZH vërente se ishin 693 profile unike të ADN-së, të marra nga mbetjet mortore, të cilat nuk kishin asnjë përputhje korresponduese me asnjë nga, në atë kohë 14,517 referencat familjare të mbledhura nga KNPZH. Sot numri i profileve unike të papërputhura të ADN-së të nxjerra nga mostrat post-mortem mbetet në 700 dhe asnjë nga këto nuk përputhet me asnjë nga, sot, 14,810 referencat familjare. Shiko figurën 6 më poshtë.




Figura 6:

Numri i grupeve të pa përputhura i profileve referente familjare të ADN-së dhe numri i pa përputhur i profileve post-mortem

Një nga çështjet kyçe që duhet të trajtohet në mënyrë që të lëvizet procesi përpara është zgjidhja e pyetjes se pse 1,876 raste të personave të zhdukur, për të cilët KNPZH ka sete të plota të referencave të gjakut të dhëna nga 5,600 anëtarë të familjeve, nuk përputhen me asnjë nga 700 profile unike të ADN-së të nxjerrë nga kockat. Ka të ngjarë që identifikimet e gabuara të ndodhura gjatë viteve 1999 dhe 2002, para futjes së testimit të ADN-së si mjet primar për identifikimin njerëzorë, janë faktor i rëndësishëm në mungesën e zgjidhjes së rasteve të këtyre mbetjeve. Kjo situatë është e pandryshuar për një dekadë, pavarësisht përpjekjeve masive nga ana e EULEX dhe KNPZH.

Për tu futur më thellë në çështjen e profileve të ADN-së nga mostrat post-mortem, ekspertët mjeko-ligjorë të EULEX-it të vendosur në DML filluan shqyrtimin e mbetjeve të paidentifikuara mortore, Rastet Pa-Emër (NN) në morgun e Prishtinës në vitin 2010. Kjo përfundoi në vitin 2012. Në raportin e tij vjetor të vitit 2012, DML i EULEX-it përcaktoj se kishte 342 raste NN në morgun e Prishtinës. Nga ky numër, 246 ishin meshkuj, nga të cilët 157 (64%) ishin skelete dhe 89 (36%) ishin pjesë të fragmentuara skeletore.⁴⁶ Kishte 96 NN raste të gjinisë femërore nga të cilat 82 (85.4%) ishin skelete dhe 14 (14.6%) pjesë shumë të fragmentuara skeletore.⁴⁷ Nga meshkujt, pothuajse dy të tretat (61.4%) kishin shenja të traumës së dhunshme, më së shpeshti, plagë nga armët e zjarrit. Tek femrat, 27 për qind kishin shenja të traumës së dhunshme. DML i EULEX-it në

⁴⁶EULEX-IFM Raport i Aktiviteteve Vjetore (2012-IFM-005), faqe 7.

⁴⁷Ibid, faqe 8.

“PËRKRAHJE PËR ZGJIDHJEN E RASTEVE TË PERSONAVE TË ZHDUKUR – THYERJA E NGËRÇIT”

raportin e tij theksoi se nga 342 raste, 94 mundë të identifikohen në të ardhmen ndërkohë që identifikimi nuk do të ishte i mundshëm për 248 rastet tjera.⁴⁸

Shqyrtimi i rasteve NN në morgun e Prishtinës ka rezultuar me dërgimin e një numri të madh të profileve post-mortem tek KNPZH për testimin e ADN-së dhe EULEX IML raporton se 45 raste të personave të zhdukur janë zgjidhur në bazë të analizës së ADN-së të KNPZH-së.⁴⁹ Megjithatë, në kohën e hartimit të këtij raporti, ngelen akoma 700 profile unike të papërputhura në bazën e të dhënave të KNPZH-së, një numër ky i cili nuk përputhet me numrin e rasteve NN të cilin e raporton të ruajtur në morgun e Prishtinës, IML i EULEX-it. Për më tepër, një numër i madh i rasteve të lidhura me konfliktin të mbetjeve njerëzore të paidentifikuara janë akoma në ruajtje në morgun e Prishtinës dhe IML të EULEX-it. Duhet të zhvillohet një plan për mënyrën se si do të zgjidhen këto raste i cili domosdoshmërisht do të përfshinte trajtimin e çështjes së identifikimeve të mundshme, të gabuara, bazuar në metodat tradicionale.

Në raportin e vitit 2011, DML bëri një klasifikim të rasteve aktive. Për personat e zhdukur shqiptarë të Kosovës, kategoritë përfshinin: "Të djegur", "Përtej Kosovës", "Kosovë (Dren)", "Rastet e tjera", "Identifikimet e gabuara" dhe "Të pa kategorizuar". Në raport, DML dha një shifër prej 70 identifikimeve të gabuara të gjithsej 1,299 shqiptarëve të zhdukur të Kosovës. DML vuri në dukje në raport se janë 428 shqiptarë të zhdukur të Kosovës të cilët janë "të pa kategorizuar" dhe 102 "raste të tjera"⁵⁰. DML nën kategorizoi 428 raste të "pa kategorizuara" në grupet e mëposhtme: "varrezat në Kosovë", "varrosjet joformale", "varrimet e fshehta" dhe "NN të mbajtura në DML". Këto nën-kategorizime nuk përjashtojnë mundësinë e identifikimeve të gabuara.

Siç vuri në dukje KNPZH në raportin e tij të vlerësimit të gjendjes në Kosovë në vitin 2010, bazuar në rezultatet e përpjekjeve për t'iu përgjigjur kërkesave familjare për identifikimin me ADN-së për të konfirmuar punën e identifikimeve, e cila fillimisht është ndërmarrë në Kosovë pa përdorimin e ADN-së, shkalla e keqidentifikimit mund të jetë së paku 17 për qind. ICMP ka kryer analizën e ADN-së të 77 rasteve nga zona e Mitrovicës që më parë ishin mbyllur duke përdorur vetëm metodat tradicionale të identifikimit. Rezultatet treguan se 13 prej 77 identifikimeve origjinale ishin të pasakta.⁵¹ Duke marrë parasysh se rreth 2000 raste janë mbyllur duke përdorur metoda tradicionale në vitin 1999 dhe 2000, numri i identifikimeve të pasakta mund të numëroj të paktën 340 raste, duke u bazuar në proporcionin e identifikimeve të gabuara që KNPZH korrigjoi me analizën e ADN-së nga zona e Mitrovicës. Kjo konfirmon nevojën për të trajtuar çështjen e identifikimeve të gabuara në mënyrë më specifike, si një mjet për të siguruar informacion për familjet e të zhdukurve.

Arsyeja pse identifikimet e gabuar mundë të jenë kontribuues të situatës aktuale, është se familjet të cilat kanë pranuar trupin e keq identifikuar me metoda tradicionale me gjasë nuk kanë dhënë mostrat e gjakut për testimin e ADN-së. Nga ana tjetër, trupat e identifikuar gabimisht me metoda tradicionale nuk do jenë testuar me ADN dhe rrjedhimisht nuk do të arrihet përputhja për familjet që i përket personi i zhdukur.

Mbledhja e mostrave referente gjenetike nga anëtarët e familjes të cilët kanë identifikuar të afërmit e tyre përmes mjeteve jo-shkencore, d.m.th pa ndihmën e ADN-së, mund të mundësojnë

⁴⁸ *Ibid*, faqe 10.

⁴⁹ *Ibid*, faqe 9.

⁵⁰ Raporti i Aktivitetëve Vjetore të IML EULEX 2011 (2012-Dfm-005).

⁵¹ KNPZH, Situata në Kosovë – Vlerësimi i Gjendjes, 2010 f.8

“PËRKRAHJE PËR ZGJIDHJEN E RASTEVE TË PERSONAVE TË ZHDUKUR – THYERJA E NGËRÇIT”

zgjidhjen e një numri të konsiderueshme të mbetjeve mortore të paidentifikuara në morgun e Prishtinës, dhe të sigurojë drejtimin e qartë për të synuar trajtimin e identifikimeve të gabuara..

X. PËRFUNDIMET

Tetëmbëdhjetë vjet kanë kaluar që nga fundi i konfliktit në Kosovë. Një përpjekje e rëndësishme është bërë për të gjetur dhe identifikuar personat e zhdukur. Operacionet në terren kanë rezultuar në zhvarrimin e më shumë se 6000 rasteve të mbetjeve njerëzore në Kosovë, dhe pothuajse 900 në Serbi. Që nga viti 2002 më shumë se 2,500 raste të personave të zhdukur janë zgjidhur nëpërmjet përdorimit të testimit të ADN-së. Rreth 2,000 raste janë identifikuar nga metodat tradicionale të identifikimeve vizuale para 2002. Sot, mbi 1,600 persona akoma vazhdojnë të jenë të zhdukur.

Familjet e të zhdukurve, edhe pse të rraskapitur pas 17 vitesh në kërkim të përgjigjeve, vazhdojnë të luajnë një rol aktiv në këtë proces dhe vazhdojnë të llojnë autoritetet për përgjigje.

Ligji për personat e zhdukur, i cili përcakton të drejtat e familjeve dhe obligimet e autoriteteve, është miratuar në Kosovë, edhe pse zbatimi i tij nuk është i plotë. Në Kosovë familjet e personave të zhdukur mund të realizojnë përfitime sipas *Ligjit për Dëshmorët*, edhe pse familjet e veteranëve të zhdukur marrin pagesa më të mëdha se sa familjet e civilëve të zhdukur. Në Serbi, një ligj për personat e zhdukur ende nuk është miratuar. Familjet e personave të zhdukur në Serbi kanë qasje të kufizuara në përfitimet në bazë të *Ligjit për viktimat civile të luftës*, por vetëm nëse ata regjistrojnë të afërmit e tyre të zhdukur si të vdekur.

Në Kosovë, Komisioni për Persona të Zhdukur i autoriteteve vendore është funksional që nga viti 2006. kapacitetet e tij janë të kufizuara dhe ai ka vetëm mbështetjen e heshtur politike të autoriteteve të Kosovës. Kompetenca për të bashkëpunuar me institucionet vendore dhe ndërkombëtare dhe me familjet e të zhdukurve është komprometuar nga fakti se edhe Instituti i Mjekësisë Ligjore i është paraparë kjo kompetencë sipas Ligjit për Mjekësi Ligjore. Në Serbi, një Komisioni për Persona të Zhdukur ka qenë funksional që nga viti 1991. Ai është institucioni i vetëm në Serbi përgjegjës për koordinimin e kërkimit të personave të zhdukur.

Regjistri Qendror për personat e zhdukur që përmban të dhëna mbi rastet aktive të personave të zhdukur është krijuar nga Komisioni i Kosovës për Persona të Zhdukur. Ai nuk përmban, megjithatë, të dhëna për raste të mbyllura. KNKK mirëmban një listë të përkohshme për personat e zhdukur nga ngjarjet në Kosovë, e cila është rënë dakord nga autoritetet në Beograd dhe Prishtinë. Po bëhen përpjekje për të krijuar një bazë të dhënash rajonale të rasteve aktive të personave të zhdukur nga konfliktet në ish-Jugosllavi, e cila do të përfshijë të dhënat e paraqitura nga komisionet e Serbisë dhe Kosovës për Persona të Zhdukur, dhe do të sigurojë numra të përditësuar në kohë reale.

Dorëzimi gradual i kompetencave nga bashkësia ndërkombëtare (EULEX-i) deri te autoritetet e Kosovës ka ndodhur. Prokurorët vendor nga PSK janë sot përgjegjës për lëshimin e urdhrave për zhvarrosjen e varrezave klandestine në territorin e Kosovës. Megjithatë, EULEX-i vazhdon të ketë mandat ekzekutiv për çështjen e personave të zhdukur.

Shkalla e zbulimit të varrezave klandestine ka rënë në mënyrë dramatike që nga viti 2005, pavarësisht përpjekjeve të rëndësishme të ndërmarra nga komuniteti ndërkombëtar.

“PËRKRAHJE PËR ZGJIDHJEN E RASTEVE TË PERSONAVE TË ZHDUKUR – THYERJA E NGËRÇIT”

KNPZH ka 700 profile të papërputhura të ADN-së të nxjerra nga mostrat post-mortem, të cilat nuk përputhen me referencat gjenetike të dhëna nga familjet të cilat akoma kërkojnë të afërmit e tyre të zhdukur,, të cilat përfaqësojnë 1,876 persona të zhdukur. Ka shumë mundësi që kjo situatë është rezultat i rreth 2,000 identifikimeve tradicionale të bëra në periudhën 1999-2002 kur individët u identifikuan në bazë të rrobave dhe gjësendeve personale të gjetura bashkë me mbetjet mortore, që rrit rrezikun e gabimeve.

Familjet e të zhdukurve kanë kërkuar në mënyrë të përsëritur nga autoritetet e Kosovës dhe Serbisë për një proces të hapur dhe transparent për të adresuar çështjen e ndërlidhur të identifikimeve të gabuara dhe rasteve të NN. Në takimin e familjeve të të zhdukurve, i cili përfshinte anëtarë të familjeve të serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës, të pritur nga LMT, Princi i Uellsit në Shtëpinë Clarence në Londër, në mars 2017, ishte ngritur edhe çështja e identifikimeve të gabuara dhe rasteve NN. Familjet ju bënë thirrje autoriteteve të kenë rol udhëheqës për të zgjidhur rastet në mënyrë sistematike. Është e qartë se çështja e identifikimeve të gabuara duhet të trajtohet më në fund.

XI. REKOMANDIMET

11.1. Bashkëpunimi i shtuar Institucional, Politik dhe Përgjegjësia Financiare

- 1) Autoritetet e Kosovës dhe Serbisë duhet të shqyrtojnë bashkëpunimin e drejtpërdrejtë për të hetuar rastet e personave të zhdukur nga konflikti në Kosovë.
- 2) Kërkohet demonstrim i vullnetit më të madh politik për të trajtuar çështjen nga autoritetet në Kosovë dhe Serbi. Demonstrimi i tillë do të përfshinte:
 - a. Autoritetet në Kosovë dhe Serbi duhet të alokojnë më shumë burime njerëzore dhe financiare për Komisionet rrespektive për Personat e Zhdukur;
 - b. Autoritetet në Kosovë duhet të fuqizojnë kapacitetet teknike të IML dhe SPK. Komuniteti ndërkombëtar duhet të sigurojë pronësi të plotë vendore mbi hetimin e rasteve të personave të zhdukur duke ja dorëzuar të gjitha këto raste PSK-së;
 - c. Autoritetet Serbe, duhet të bëjnë publike gjetjet e tyre nga hetimet e pretendimeve se mbetjet njerëzore janë asgjësuar në fabrikëne aluminit në Mackatica (afër Surdulicës) në Serbinë Jugore në maj të vitit 1999. Ky është parakusht për një proces transparent të gjetjes së personave të zhdukur nga konflikti në Kosovë dhe është i domosdoshëm në mënyrë që të përfundojnë spekulimet nga ana e familjeve të të zhdukurve, të cilat kërkojnë përgjigje.

11.2. Legjislacioni

- 1) Implementimi i plotë i Ligjit të Kosovës për Personat e Zhdukur, përfshirë:
 - a. Ministria e Drejtësisë e Kosovës të propozojë akte nënligjore për përfundimin e kërkimit, të cilat më pas duhet të miratohen nga autoritetet e Kosovës;
 - b. Komisioni i Kosovës për Persona të Zhdukur të miratojë një rregullore që

“PËRKRAHJE PËR ZGJIDHJEN E RASTEVE TË PERSONAVE TË ZHDUKUR – THYERJA E NGËRÇIT”

përcakton procedurat që lidhen me regjistrin qendror të Personave të Zhdukur, duke përfshirë përdorimin, regjistrimin, përjashtimin dhe shkëmbimin e të dhënave, si dhe verifikimin dhe menaxhimin e tij në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ligjin për Klasifikimin e Informacioneve; dhe

- c. Autoritetet e Kosovës të emërojnë Zëvendës Kryesuesin e Komisionit të Kosovës për Personat e Zhdukur nga komuniteti jo-shumicë.
- 2) Serbia duhet të ndryshojë Ligjin për invalidët civilë të luftës dhe Kodin e Procedurës Penale për të zgjeruar përkufizimin e një viktime ku të përfshijë personat e zhdukur dhe palën e dëmtuar që do të përfshinte familjet e të zhdukurve në mënyrë që familjet e personave të zhdukur të jenë në gjendje të realizojnë të drejtat dhe përfitimet sipas ligjit.

11.3. Familjet e të zhdukurve

- 1) Autoritetet kosovare dhe serbe duhet të forcojnë përpjekjet për të siguruar të drejtat e familjeve të të zhdukurve për të vërtetën, drejtësinë dhe dëmshpërblimet, pavarësisht nga origjina e tyre etnike, fetare ose kombëtare, ose rolin e tyre gjatë konfliktit.
- 2) Autoritetet e Kosovës dhe të Serbisë duhet të ofrojnë mbështetje financiare për aktivitetet e shoqatave të familjeve të zhdukurve.
- 3) Shoqatat e familjeve të të zhdukurve duhet të kërkojnë për të forcuar më tej kapacitetet e tyre organizative, dhe bashkëpunimin e përbashkët.
- 4) Shoqatat e familjeve të të zhdukurve duhet të inkurajojnë përfshirjen më të madhe të të rinjve në punën e tyre për të siguruar qëndrueshmërinë e procesit.

11.4 Sistemet e të Dhënave

- 1) Duhet të ndërmerret një proces i hapur dhe transparent i shqyrtimit të listës së konsoliduar të personave të zhdukur.
- 2) KQPZH i Kosovës duhet të sigurojë përfundimin e Regjistrit Qendror të Personave të Zhdukur, përfshirë edhe rreth 3,000 raste të mbyllura.
- 3) IML, i cili i mban të dhënat për rastet e mbyllura, duhet të vazhdoi ti vërë në dispozicion këto të dhëna për KQPZH në mënyrë që të sigurohet përmbyllja e Regjistrit Qendror të Personave të Zhdukur.
- 4) KQPZH i Kosovës duhet të vendos Regjistrin Qendror të Personave të Zhdukur Online, dhe në mënyrë të vazhdueshme të menaxhojë dhe përditësoj bazën e të dhënave në mënyrë që të ju ofroj familjeve të personave të zhdukur të dhëna të sakta, në kohë dhe në mënyrë transparente.
- 5) KQPZH i Kosovës dhe KQPZH i Serbisë duhet të marrin pjesë plotësisht në krijimin e bazës së të dhënave për rastet e hapura të personave të zhdukur në ish Jugosllavi

“PËRKRAHJE PËR ZGJIDHJEN E RASTEVE TË PERSONAVE TË ZHDUKUR – THYERJA E NGËRÇIT”

duke ofruar të dhënat minimale të kërkuara për rastet e hapura të personave të zhdukur në mënyrë që KNPZH ti përfshijë në bazën e të dhënave.

11.5. Shkenca dhe Teknologjia

- 1) Komisioni i Kosovës për Persona të Zhdukur, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë së Kosovës, duhet të koordinojë një proces shumë agjencish, duke përfshirë IML-EULEX dhe KNPZH, si dhe të mbajë të përditësuar Komisionin Serb për Persona të Zhdukur, në mënyrë që të trajtohet çështja e mbetjeve të paidentifikuara njerëzore dhe identifikimet e gabuara të mundshme përmes:
 - a. Shqyrtimit të hapur dhe transparent të rasteve të mbyllura me metoda tradicionale të identifikimeve të supozuara të shoqëruara me vlerësimin e rasteve të paidentifikuara në morgun e Prishtinës për të përcaktuar shkallën në të cilën identifikimet e gabuara të cilat mund të kenë ndodhur para futjes në përdorim të analizës së ADN-së si mjet kryesorë për identifikimet njerëzore; dhe
 - b. Mbledhjes së mostrave referente gjenetike shtesë nga anëtarët e familjeve të cilët kanë varrosur të afërmit e tyre pa përdorimin e teknologjisë së ADN-së, me qëllim që mundësisht, të identifikohen rastet NN dhe të përcaktimit se ku kanë ndodhur identifikimet e gabuara para nisjes së procesit të identifikimit të udhëhequr me ADN në vitin 2002.